

Kosova dhe Bota Arabe

Konferencë ndërkombëtare, e mbajtur më 25 Gusht 2008
në Prishtinë

Maj 2009
Prishtinë

Botues: Forum 2015

Financuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Disenj, faqosje dhe shtyp: Adnan Rezniki CO

Tirazhi: 1000

PËRMBAJTJA

7 Luan Shllaku

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

11 Fatmir Sejdiu

President i Republikës së Kosovës

13 Skender Hyseni

Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës

15 Veton Surroi

Klubi për Politikë të Jashtme

19 Ridwan al-Sayed

Këshilltar i Kryeministrit Libanez Fouad Siniora, Liban

23 Muhamet Mustafa

Instituti RIINVEST

25 Muhamedin Kullashi

Universiteti Paris 8

33 Ferid Agani

Universiteti i Prishtinës

39 Bekim Sejdiu

Këshilltar i Lartë i Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës

43 Jamal Barout

Forumi Syria 2025, Siri

45 Hany Salah

Agjensioni i lajmeve "IslamOnline", Egjipt

47 Muhamed Mufaku

Universiteti Al Al-Bajt, Jordani

49 Omar Kouch

Gazeta al-Arab e Katarit, Liban

53 Nehat Islami

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

55 Qemajl Morina

Fakulteti i Studimeve Islame Prishtinë

59 Mohannad Mubaidin

Universiteti Filadelfia në Amman, Jordani

61 Hazem Ameen

Gazeta al-Hayat, Liban

63 Mufleh Odwan

Spektori i Kulturës në Pallatin Mbretëror, Jordani

65 Për Forumin 2015

HYRJE

Si reagim ndaj nevojës urgjente për një kampanjë efektive dhe proaktive për imazhin ndërkombëtar të Kosovës, Forumi 2015 inicioi procesin e përmirësimit të imazhit të Kosovës jashtë vendit. Në këtë drejtim, Forumi 2015 ka përgatitur analizën mbi paragjykimet më të mëdha rreth Kosovës që promovohen nga media e huaj mbi realitetin pas pavarësisë. Paralelisht, një kampanjë e diplomacisë civile synon mobilizimin e potencialit intelektual rreth Forumit 2015 për përmirësimin e imazhit të Kosovës në vende të ndryshme të botës, që janë skeptike rreth pavarësisë dhe të informuar keq si pasojë e anti-kampanjave të forta. Hap i parë ishte dërgimi i një grupi të intelektualëve kosovarë në Amman të Jordanisë për të themeluar kontakte dhe mbajtur takime me intelektualë me ndikim dhe aktivistë të shoqërisë civile në botën arabe. Gjatë kësaj vizite, Forumi 2015 në bashkëpunim me Al-Quds Center for Political Studies, organizoi konferencën “Kosova dhe bota Arabe”, duke i tubuar 60 personalitete me ndikim nga Jordani, Egjipti, Libani, Siria dhe vendet tjera arabe. Konferenca në Amman u prit mjaft pozitivisht nga bota arabe, duke reflektuar edhe një herë mbi mungesën e kanaleve të komunikimit mes Kosovës dhe kësaj pjese të botës. Në mënyrë të rezultatit dhe të arriturat e këtij procesi të jenë sa më afatgjatë dhe të qëndrueshme, Forumi 2015 organizoi edhe konferencën e dytë me tematikë të njëjtë, e cila u mbajt në Prishtinë, me pjesëmarrje të intelektualëve nga shtetet e ndryshme arabe. Mysafirët e jashtëm, bashkë me intelektualët dhe aktivistët e shoqërisë civile nga Kosova prezantuan kumtesat e tyre mbi marrëdhëniet Kosovë – botë Arabe. Konferenca, e cila u mbajt më 25 Gusht 2008, përveç paneleve të shquara, tuboi edhe një audience të nivelit shumë të lartë, të përbërë nga udhëheqës institucionalë, diplomatë, aktivistë të OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare, intelektualë dhe media.

Konferenca ofroi një impuls drejt themelimit dhe forcimit të kanaleve të komunikimit mes shoqërisë civile të Kosovës dhe vendeve arabe. Pas hapit të parë, të ndërmarrë në Amman të Jordanisë, panelistët e konferencës në Prishtinë, të cilët kishin ardhur nga Jordania, Arabia Saudite, Egjipti, Siria, Libani, etj, diskutuan për shtetësinë e Kosovës dhe marrëdhëniet Kosovë-Arabe. Në këtë konferencë, me diskutimet e tyre u paraqitën edhe emra të njohur të jetës publike, civile dhe akademike të Kosovës: Fatmir Sejdiu, Skënder Hyseni, Veton Surroi, Muhamet Mustafa, Muhamedin Kullashi, Ferid Agani, Nehat Islami, Bekim Sejdiu dhe shumë të tjerë.

Ky publikim është përmbledhje e kumtesave, prezantimeve dhe diskutimeve nga konferenca ndërkombëtare “Kosova dhe Bota Arabe” të mbajtur në Prishtinë, më 25 Gusht 2008. Publikimi paraqet një referencë të fuqishme të shkruar eksklusivisht për marrëdhëniet e Kosovës me shtetet e botës arabe, ku ekspertë dhe intelektualë të shquar nga shtetet arabe dhe Kosova i ofrojnë analizat dhe këndvështrimet e tyre mbi nevojën, mënyrën dhe përfitimet e themelimit dhe thellimit të marrëdhënieve mes vendeve tona.

LUAN SHLLAKU

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

I nderuari Kryetar i Republikës zoti Sejdiu, dhe Ministër i Punëve të Jashtme, zoti Hyseni, i nderuari Kryetarë i Komunës së Prishtinës, të nderuar mysafirë nga vendët Arabe, nga Ambasadat dhe zyrat përfaqësuese në Kosovë, të nderuar përfaqësues të institucioneve qeveritare, partive politike, shoqërisë civile, medieve, bizneseve,

Zonja e zotërinj mirëmëngjez, dhe mirëserdhët në Forumin e radhës, të organizuar nga koalicioni për integritet Euro-Atlantike, Forum 2015. Sot jemi mbledhur të diskutojmë rreth temës Kosova dhe Bota Arabe. Është kjo konferenca e dytë që mbahet me këtë temë. E para është mbajtur në Aman, në korrik të këtij viti. Sot në mes nesh kemi të ftuar shumë mysafirë të nderuar nga vende të ndryshme Arabe, dhe me këtë rast do të doja që në emër të Forumit dhe të gjithë ne që jemi sot këtu, t'i falënderohesha që pranuan ftesën tonë për të qenë sot me ne, në këtë konferencë ku do të diskutojmë tema të rëndësishme për bashkëpunimin e vendeve tona në të ardhmen.

Pjesëmarrës të nderuar, zoti President dhe zoti Ministër, më lejoni që në fillim të ju informojë se Forumi 2015 tashmë ka hyrë në ciklin e tretë të temave apo më mirë të them të çështjeve që trajton, me pjesëmarrje të gjerë të potencialit intelektual që Kosova posedon sot, qoftë ai në institucione qeveritare, civile, Universitet, biznese media apo gjetiu, për të debatuar fillimisht e më vonë edhe vepruar në mënyrë strategjike në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare sot.

Ky cikël temash që jemi duke e shtjelluar ka të bëjë me imazhin e Kosovës jashtë vendit, që sot është jo real, dhe në shumë raste është i ngarkuar me paragjykime që janë duke na sjellë mjaft telashe atëherë kur punojmë për përmirësimin e pozitës tonë ndërkombëtare. Kjo vjen si rezultat i asaj që kemi bërë dhe asaj që se kemi bërë në të kaluarën për ta përmirësuar këtë gjendje, dhe jo vetëm në periudhën e pas-pavarësisë, kur moskuptimet dhe propaganda e qarqeve të caktuara që të gjithë i njohim është shumëfishuar. Forumi 2015 tashmë e ka përfunduar një studim të kësaj çështje, ku argumentohet fare lehtë se situata në shumë lëmi, siç janë niveli i krimit të përgjithshëm, krimi ndër-etnik, trafikimi i qenieve njerëzore dhe i drogës, korupcioni etj. janë larg më të ulët se që sot propagandohet në shumë anë dhe nga shumë qarqe jashtë Kosovës, dhe në disa raste qëndrojmë më mirë se shumë vende europiane. Së shpejti Forumi do të del me këto rezultate dhe do t'i prezantojë në një tryezë të radhës në Prishtinë por edhe jashtë Kosovës, në qendra ndërkombëtare vendimmarrëse.

Thash më parë se ky është cikli i tretë i çështjeve që shqyrton Forumi 2015. Më lejoni të ju përkujtojë se Forumi në vitin 2004 e filloi ciklin e parë të temave, për të cilat bëri shumë analiza dhe i prezantoi brenda dhe jashtë Kosovës, në Bruksel, Paris, Tiranë, Londër, me titullin "Pse pavarësi për Kosovën?". Më vonë, filluam një seri të dytë të çështjeve të rëndësishme për kohën para statusit, të cilën e quajtëm "Statusi kundër Status Quo-s". Shumë tema të rëndësishme për këtë periudhë janë shqyrtuar dhe shumë studime janë bërë nga organizatat dhe autorë Kosovarë dhe të jashtëm, të cilat fare lehtë mund t'i gjeni në ueb-faqen e Forumit 2015. Dhe gjithmonë qëllimi ynë ishte dhe vazhdon të jetë të mobilizojmë potencialin kosovar

në zgjidhjen e problemeve më të mëdha që kemi sot.

Pjesëmarrës të nderuar, sot do të diskutojmë një temë të rëndësishme që në një mënyrë i prek pak a shumë të gjitha debatet e bëra në Forum deri tash: jam i bindur se sot do të diskutojmë për politikën e jashtme, posaçërisht karshi vendeve arabe, dhe jam i lumtur që edhe Ministria e Kosovës për Punë të Jashtme, do të jetë pjesë aktive e këtij debati, nëpërmes të Ministrit dhe përfaqësuesve tjerë të saj që sot janë prezent në këtë tryezë; do të diskutojmë poashtu për bashkëpunimin ekonomik, social, kulturorë dhe çështje tjera vitale; dhe posaçërisht do të flasim për sfidën e hapjeve të kanaleve të komunikimit në mes nesh si parakusht për krijimin e një partneriteti afatgjatë dhe të qëndrueshëm me botën Arabe. Mendoj se ne jemi posaçërisht të predispozuar që të kuptojmë mirë njëri tjetrin, të bisedojmë me njëri tjetrin dhe të ndihmojmë njëri tjetrin. Është kjo një platformë universale për bashkëpunim të mirë në mes vendeve të ndryshme.

Sot, ne në Kosovë synojmë të jem pjesë e Bashkimit Evropian. Dhe kjo është shumë e arsyeshme. Të jesh sot, në kohën e globalizimit të shumë segmenteve të rëndësishme të jetës, pjesë e bashkimeve të gjëra, është vetëm një përparësi, posaçërisht për shtetet e reja, siç jemi ne. Kosova është në Evropë, dhe Evropa mund t'i sjellë Kosovës më shumë perspektivë për zgjidhjen e problemeve që ajo ka sot. Mirëpo, në kohën e globalizmit, nuk është vetëm ekonomia ajo që i sfidon këto trende - trendet për të qenë pjesë e një organizimi më të madh.

Ne kemi shumë gjëra të përbashkëta edhe me pjesë tjera të botës. Me vendet arabe nuk na lidhin vetëm sfidat e bashkëpunimit politik dhe ekonomik, me vendet arabe na lidh edhe një histori e përbashkët gadi 5 shekujloze, nga e cila vijnë shumë lidhje, miqësi, dhe sfida bashkëpunimi. Në këtë periudhë ne morëm nga trashëgimia e pasur e kësaj ane të botës shumë, dhe shpresojmë se edhe i dhamë poashtu shumë, edhe pse ishim vend i vogël, në një imperie të madhe. Jam i bindur se shumë diskutant sot në këtë tryezë do të flasin për këtë trashëgimi të përbashkët.

Kosova sot gjendet në një periudhë shumë të rëndësishme të zhvillimit të saj, kur krahas shtetësisë, duhet ta ndërtojë edhe ekonominë e saj. Për Kosovën sot është e një rëndësie të njëjtë, dhe vitale, që të krijojë kushte që çdo ditë të pranohet nga të paktën një shtet, dhe çdo ditë të jetë në gjendje të punësojë 100 qytetarë të saj të papunë. Dhe mbi të gjitha na duhet që çdo minutë të punojmë për ndërtimin dhe realizmin e projekteve që do ta shtyjnë përpara shtetësinë tonë, ekonominë tonë, dhe institucionet tona demokratike. Bota arabe ka potencial edhe politik dhe ekonomik të mjaftueshëm që të na ndihmojë në këtë, dhe jam i bindur se do ta bëjnë, herët a vonë. Ne në Forum 2015 jo rastësisht jemi organizuar që të sjellim njerëz të rëndësishëm dhe me influencë të shoqërisë arabe, për t'i informuar më mirë për realitetin tonë sot, për projektet tona, për nevojat dhe sfidat tona. Ata kanë pranuar me dëshirë të na ndihmojnë në këtë projekt, dhe ne u jemi shumë falënderues për gatishmërinë e shprehur.

Sot Kosova më shumë se kurrë më parë, ka nevojë për miq. Ka nevojë për miq me të cilët do ta ndërtojë ardhmërinë e saj, në baza të forta bilaterale, nga e cila miqësi të gjithë do të përfitonin. Kosova ka potencial për zhvillim në pothuaj se të gjitha fushat, por na duhen investime të jashtme. Shumica e vendeve arabe ka potencial për të investuar, dhe ne shpresojmë se do vijnë së shpejti edhe në Kosovë. Sot jemi mbledhur për të dërguar mesazhe bashkëpunimi, dhe për t'i informuar miqtë ton

arab për nevojat tona imediate. Ne na duhet që sa më parë vendet arabe ta njohin zyrtarisht pavarësinë e Kosovës, dhe na duhet krahas kësaj të vendosim komunikim më efikas në mes të ekonomistëve dhe biznesmenëve nga të dy anët, në mes të institucioneve kulturore dhe atyre shpirtërore, në mes të shoqërive civile, medieve, Universiteteve për ta eksploruar më shumë dhe më mirë potencialin institucional dhe intelektual që e posedojmë. Është kjo konferencë dhe ajo e organizuar më parë në Aman, dëshmi se ky potencial dhe këto qëllime të mira ekzistojnë.

Kosova është shumë vend i vogël për të bërë ndarje në ata që kanë dhe ata që nuk kanë mandat të punojnë për avancimin e proceseve që shoqërinë kosovare e qonë përpara. Dhe jam i bindur se në këtë pikë ekziston një konsensus i plotë në mes të institucioneve dhe intelektualëve kosovarë. Zoti President, zoti Ministër, pjesëmarrës të nderuar, le të flasim një gjuhë sot!

FATMIR SEJDIU

President i Republikës së Kosovës

Faleminderit z. Shllaku, z. Mustafa dhe të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë të rëndësishme të Forumit 2015. Unë dëshiroj që në fillim të ғmoj këtë iniciativë të rëndësishme që ju e keni marrë, në kuptimin e trajtimit të temave të shumta që lidhen me të tashmen, të ardhmen dhe perspektivën të shoqërisë dhe të shtetit të Kosovës dhe them po kështu se kam qenë pjesëmarrës edhe në konferencat e mëhershme në temat që ju keni zgjedh. Do ta keni bashkëpunimin dhe mbështetjen time dhe të institucioneve të Kosovës dhe mendoj se edhe kjo temë boshte e ditës së sotme që ju keni pas përkushtimin ta keni në trajtesë të thellë meriton një qasje shumë dimensionale e cila në të parën e së parës do të jetë pjesë e rëndësishme e hapjes së një kaptine të re të bashkëpunimit në mes të institucioneve të kulturës dhe të shoqërisë civile po pse jo mos të themi edhe një taban i rëndësishëm i zhvillimit të marrëdhënieve edhe në mes vendeve. Besoj se gjatë debatit që do të keni do të shtroni aspekte të shumta që lidhen me rrafshet që edhe ju potencuat dhe ato që kanë të bëjnë me njohjen e realitetit praktik të Kosovës, përkatësisht të shtetit të Kosovës, i mbështetur në vlerat e veta, në identitetin e qartë që e ka, në hapjen e mundësive të bashkëpunimeve ekonomike, në hapjen e mundësive të bashkëpunimeve kulturore, dhe në hapjen e mundësive të bashkëpunimeve edhe në fusha të tjera që janë të rëndësishme të veçantë dhe posaçërisht ato që kanë të bëjnë me karakterin e këmbimeve ndëruniversitare. Me këtë rast dua të them se pikërisht në këto moment apo në këtë kohë që jetojmë është një përkushtim i veçantë i yni, është një përkushtim i veçantë kujtoj edhe i këtyre njerëzve që kanë ardhur këtu sot, dhe i tjerëve që përmes kanaleve të ndryshme i kemi kontaktuar që të shpejtohet në mënyrën ma të mirë të mundshme në njohjen e realitetit dhe në hapjen e mundësive më të shumta për këto perspektiva të zhvillimit të marrëdhënieve. Për ne është shumë me rëndësi të themi se Kosova ka prit dhe pret me besim dhe bindje të plotë se vendet e këtij rajoni që përfaqësojnë edhe njerëzit që janë mysafirë të tanishëm në Kosovë do të kenë pasur mundësi dhe do të kenë ndoshta edhe azhuritetin e veçantë që të bashkëngjiten me kuadrin apo kompozicionin e përbashkët të vendeve të tjera që kanë njohur pavarësinë e Kosovës nga dita e shpalljes e deri tani. Janë 46 vende të kontinenteve apo të katër anëve të globit që kanë mbështet qasjen themelore të shtetit të Kosovës që të jetë shtet demokratik, shtet i të gjithë qytetarëve dhe i perspektivës së tyre, shtet që cmon dhe kultivon dhe mbron të drejtat dhe liritë njerëzore. Në këtë kuadër e them edhe tani se Kosova do të mbetet e përkushtuar në këtë rrafsh themelor duke pasur parasysh se pikërisht mbi këto vlera do të shpreh më së miri identitetin e saj. Për ne është me rëndësi të theksojmë se jemi në Evropë, atë që thatë edhe ju z. Shllaku, i mbështesim dhe i aspirojmë fuqishëm integrimet euro-atlantike, për të qenë anëtarë të një familje në kontinentin e vjetër, në një familje të përbashkët me trendet më të reja të zhvillimit por në të njëjtën kohë kemi qasjen dhe ndjenjën e bashkëpunimit me të gjitha vendet e tjera në të mirë të perspektivës dhe të zhvillimeve më të mira të mundshme për qytetarët dhe për vendet tona. Në këtë kuadër dua të them se pikërisht mbi këto premisa Kosova ka dhënë dhe do të jap dëshmitë e veta më të fuqishme për të qenë faktor i rëndësishëm i paqes dhe stabilitetit, duke filluar nga fqinjësia e mirë me të gjithë fqinjët e vet, pra nesër edhe me Serbinë, përkundër qasjeve ende të ashpra që ajo mban me një retorikë thjesht që ka hy në borxh në këtë kohë edhe për popullin e vet tepër, të ashpër dhe tepër të pakalueshme në nivelet e asaj logjike apo atyre gjykimeve që kanë. Po shpresojmë dhe besojmë se do të jetë një kohë e rrafshëve

të reja të bashkëpunimeve, që edhe nga ana e tyre të njihet realiteti në Kosovë, si realitet i perspektivës për të gjithë qytetarët, dhe paralelisht të ndërpres këtë pjesë të fushatës, dhe të qasjeve që janë thjesht destruktive, të qasjeve që dëshirojnë të ndërprejnë trendin e zhvillimit të Kosovës por edhe të zhvillimeve tjera të përgjithshme duke vënë thjesht në shënjestër apo duke u përpjekur t'i bëjë pengesë të veçantë edhe njohjeve të mëtejshme të Republikës së Kosovës, por duke bërë përpjekje poashtu për të destabilizuar në forma të ndryshme qenien e saj apo trupin e saj. Ne jemi të përkushtuar që në këtë kohë t'i qasemi punës, jemi të përkushtuar t'i japim sinjalet më të mira pozitive të bashkëpunimit edhe me këtë vend edhe me vendet e tjera, dhe jemi të përkushtuar po kështu që shumë shpejt të zhvillojmë edhe nivele të tjera të bashkëpunimit me gjithë vendet e tjera. Prandaj unë nuk dua të zgjas më tepër, dëshiroj që të përshëndes këtë iniciativë që ju keni në kuadër të bashkëpunimeve me këtë nivel, me këtë prezencë të dinjitetshme të njerëzve që përfaqësojnë institucione të rëndësishme të shkencës, të kulturës dhe të shoqërisë civile, dhe po kështu të jetë pjesë e një zëri plus të arsyes, të thirrjes, të bashkëpunimit dhe të nxitjes së proceseve për bashkëpunime të rëndësishme. Unë them se Kosova do të jetë ajo që ka shënuar në Kushtetutën e vet që ka përkushtimin e veçantë që të jetë edhe një herë e përsëris shtet i të gjithë qytetarëve, shtet në të cilin do të respektohen të drejtat dhe liritë njerëzore, liritë fetare por edhe liritë dhe të drejtat e të gjithë komuniteteve. Për këtë arsye ne e quajmë këtë vlerë dhe kjo do të jetë e rëndësishme për një ecje të suksesshme më tej.

SKENDER HYSENI

Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës

Faleminderit shumë z. Shllaku, z. Mustafa,

Të nderuar zonja dhe zotërinj, të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi për mua ti drejtohem kësaj konference që mbahet në një moment të rëndësishëm për Kosovën dhe për rajonin në përgjithësi. Përmbajtja e kësaj konference si në kuptim të temave që do të diskutohen e poashtu edhe sa i përket përfaqësimit e rrit rëndësinë e saj. Duke u nisur nga këto fakte, gjej rastin t'i falënderoj organizatorët, Forumin 2015, për ftesën që më kanë bërë për të marrë pjesë. Më lejon në fillim poashtu një përshëndetje të veçantë t'ju drejtoj përfaqësuesve nga bota akademike e intelektuale nga vende të ndryshme të botës arabe.

Zonja dhe zotërinj, më 17 shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës e ka shpallur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Ky akt ishte kulmim i aspiratave të popullit të Kosovës për të jetuar i lirë. Përfundimisht falë vendosmërisë së popullit të Kosovës dhe përkrahjes së botës liridashëse sot Kosova është e lirë dhe po punon për ndërtimin e shtetit të vet demokratik mbi parimet e respektimit të plotë të drejtave të njeriut dhe të pakicave etnike. Kosova pra mbetet fuqimisht e përkushtuar ndaj Propozimit Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari dhe Qeveria e Kosovës tashmë ka hartuar plane të veçanta për zbatimin në terren të dispozitave nga kjo Pako, në veçanti të asaj pjesë që ka të bëjë me mbrojtjen e pakicave, e sidomos të asaj serbe. Qeveria e Republikës së Kosovës është plotësisht e vetëdijshme se shpallja e pavarësisë nuk i ka zgjidhur problemet e tona të shumta të natyrës sociale dhe ekonomike. Është e qartë sido që të jetë për secilin se në fazën e tanishme çështje me rëndësi jetike për institucionet dhe popullin e Kosovës është njohja ndërkombëtare e shtetit të Kosovës. Ky është parakusht i rëndësishëm për stabilitet politik dhe zhvillim ekonomik e shoqëror të Republikës së Kosovës por edhe për zhvillim të rajonit në përgjithësi. Qeveria e Kosovës punon me tërë kapacitetet e saj për të siguruar sa më shumë përkrahje ndërkombëtare për Kosovën, duke përfshirë në mënyrë të veçantë vendet e Botës Arabe me të cilat kemi kontakte e takime të shpeshta. Shpeshherë këto kontakte e takime nuk janë të lehta për shkak të pengesave të ndryshme të natyrës edhe logjistike. Kosova më të drejtë kërkon dhe pret njohje nga këto vende, në këto momente të papërsëritshme për Kosovën, momente historike për të gjithë ne. E kemi parasysh se procesi i njohjes së shteteve të reja është çështje e ndërlikuar e politikës ndërkombëtare, prandaj duke u nisur nga ky fakt Ministria e Punëve të Jashtme, e cila është themeluar më 16 qershor, një pjesë të mirë të energjisë së saj e ka përqendruar në përshpejtimin e këtij procesi. Përkundër vështirësive të shumta siç e tham të natyrës politike por edhe logjistike, Ministria e Punëve të Jashtme ka arritur që të transmetoj zërin dhe interesat e Republikës së Kosovës në vende dhe rajone të ndryshme të botës. Strategjia e veprimit të Ministrisë së Jashtme sa i përket procesit të njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës është bazuar në kontakte të drejtpërdrejta apo të tërthorta me sa shumë vende të ndryshme të botës. Përparësi në këtë drejtim i është dhënë rajoneve nga të cilat ende nuk kemi pasur shumë njohje dhe shteteve me ndikim brenda atyre rajoneve dhe brenda organizatave të caktuara ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Ministria e Punëve të Jashtme që nga dita e parë e ka trajtuar me rëndësi të dorës së parë kontaktin me vende të ndryshme të Botës Arabe dhe asaj

myslimane në përgjithësi.

Zonja dhe zotërinj, Qeveria dhe populli i Kosovës shpresojnë dhe besojnë fuqimisht se shtetet arabe edhe kësaj here do të gjenden pranë Kosovës. E them edhe kësaj herë sepse vende dhe organizata të ndryshme arabe kanë dhënë përkrahje zemërgjerë në fazën e rindërtimit dhe stabilizimit të Kosovës së pasluftës. Populli dhe institucionet e Kosovës janë dhe do t'u mbeten përgjithmonë mirënjohëse atyre vendeve arabe që kanë ofruar ndihmën e tyre qoftë përmes pjesëmarrjes ushtarake në kuadër të forcës paqeruajtëse të KFOR-it, qoftë përmes ndihmave të shumta humanitare dhe ekonomike. më lejoni të rikujtoj këtu që në Konferencën e Donatorëve për Kosovën, Arabia Saudite ka zotuar një shumë prej 50 milion dollarësh, ne e falënderojmë këtë vend të rëndësishëm dhe natyrisht presim njohje e bashkëpunim nga ky vend dhe vendet e tjera në ekonomi dhe në të gjitha veprimtaritë e jetës.

Zonja dhe zotërinj, shpresojmë dhe besojmë se mundësitë për marrëdhënie politike, ekonomike dhe të tjera të Kosovës me Botën Arabe janë të mëdha. Me njohjen e shtetit të Kosovës nga shtetet arabe do të hapej një kaptinë e re që do të mundësonte kultivimin dhe përparimin e këtyre marrëdhënieve. Populli dhe institucionet e Kosovës kanë dëshmuar qartë përkushtimin për të ndërtuar një shtet demokratik që çmon lart dhe mbron liritë njerëzore. Kosova aspirojnë të jetë pjesëmarrëse e përgjegjshme ndërkombëtare, kontribuuese e jo vetëm konsumuese e sigurisë globale dhe e aspiratës për liri dhe dinjitet njerëzor. Aspiratë kjo që e bën të fortë urën që lidh kulturat, religjionet, etnitë dhe racat e ndryshme të botës.

Ju faleminderit shumë.

VETON SURROI

Klubi për Politikë të Jashtme

1.

Para njëqind vjetësh, një distancë relativisht e shkurtër historike, paraardhësit e pjesëmarrësve kosovarë dhe arabë të kësaj tryeze, ishin pjesë të një Perandorie, asaj otomane, dhe pjesë e një momenti të njëjtë historik, zhbërjes së kësaj Perandorie.

Pas njëqind vjetësh, ende përjetojmë në një formë a tjetër dridhmat apo pasojat e dridhmade të atij momenti të historisë. Krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës, kriza e radhës për ndarje të pushtetit në Liban, mungesa e një shteti palestinez apo edhe mundësia e mbijetesës së shtetit irakian janë që të gjitha produkte origjinare të zhbërjes së Perandorisë otomane dhe të përpëlitjeve të kombeve brenda kësaj Perandorie për vetëvendosje. Dhe, natyrisht, pozicionimit të Fuqive të mëdha, Perëndimore, karshi këtyre përpëlitjeve.

2.

Duke qenë të detyruar nga historia të ishim bashkë para njëqind vjetësh, çka po ndodhë sot? Përgjigja më e thjeshtë për atë se çka po ngjet në relacionet mes Kosovës dhe botës arabe, është se çkado që të ndodhë, po ndodhë sipas një inercioni, lidhjeve të atyketushme individuale, dhe, siç do të dëshmohet në ditët e fundit, debatit të atyketushëm medial. Kosova, si shtet, nuk ka politikë ndaj botës arabe. Miqve tonë arabë, nëse u shërben si ngushëllim, do shpjeguar se Kosova, në fakt, nuk ka politikë të jashtme. Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk diskutuar për politikën e jashtme të vendit, qoftë në Komisionin e vet përkatës, qoftë në mbledhjen e vet plenare. Sot për sot, nuk ekziston ndonjë dokument udhëzues për politikën e jashtme të vendit, me të cilin do të mund të shpjegonim se çka synon ky vend në një periudhë afatshkurtër, afatmesme apo afatgjatë në marrëdhëniet e veta me botën, pra edhe me atë që njihet si bota arabe.

3.

Në mungesë të politikës zyrtare, më lejoni të shpjegoj, në vija të trasha, disa prej premisave mbi të cilat është ndërtuar lëvizja kosovare për pavarësi në dy dhjetëvjetëshat e fundit, në të cilën kam qenë i përfshirë në formë aktive, dhe disa vija të trasha të kontekstit në të cilin do ndërtuar politikën e jashtme të Kosovës karshi botës arabe. Së pari, politika kosovare për pavarësi është identifikuar fuqishëm me rënien e Murit të Berlinit dhe tërë procesin e mëtutjeshëm të bashkimit të Evropës në vlerat bazike Perëndimore. Rrjedhimisht, ndërtimi i shtetit të pavarur të Kosovës ka si kontekst më të gjerë historik atë të bashkimit të Evropës së popujve dhe shteteve të lira, dhe në këtë formë, ndërtimi i shtetit të pavarur të Kosovës është poashtu vendosja e Kosovës në gjirin e asaj që quhet bota Perëndimore. Sot, në lindjen gjeografike të Kosovës gjenden shtetet anëtare të NATO-s e BE-së, Bullgaria e Rumania. Ardhmëria e Kosovës, padyshim, është ajo e integritit në NATO e BE, pra përmbyllje e identitetit të vet perëndimor. Por, nëse çlirimi i Kosovës është produkt i një politike aktive të Perëndimit, të SHBA-ve dhe Bashkimit Evropian, procesi i pavarësimit të Kosovës ka qenë poashtu produkt i një politike globale. Gjatë tetë viteve të kaluara Kosova ka qenë e administruar nga OKB. Çfarëdo vendimi që është marrë për Kosovën prej vitit 1999 deri më sot ka pasur dhe ka reperkusione

globale. Pavarësia e Kosovës, e prodhuar pas një procesi negociatash të sponsorizuar nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së, dhe pas rekomandimit të të dërguarit të tij Marti Ahtisaari, është një akt që kërkon përgjigje globale, pra që kërkon edhe përgjigjen e botës arabe. Po të përmbledhet shkurtimisht, mund të thuhet se Kosova ka pasur dhe ka ecjen e vet të natyrshme për t'u vendosur brenda gjirit të vet të origjinës, Perëndimit, por në të njëjtën kohë e në formë paralele, edhe për vendosjen e vet brenda familjes globale.

4.

Në përcaktimin e botës arabe rreth çështjes së pavarësisë së Kosovës mendoj se rol të veçantë duhet të luajnë katër faktorë fundamentalë. I pari është trashëgimia jonë e përbashkët. Një pjesë e rëndësishme e identitetit të Kosovës është ndërtuar gjatë Perandorisë otomane. Kosova, siç thash, i përket në formë të natyrshme Perëndimit, por ajo përkatësi nuk e përjashton influencën kulturore e religjioze të Islamit që ka lënë mbresë të thellë në vendin tonë gjatë Perandorisë otomane. I dyti është synimi ynë i përbashkët për vetëvendosje. Pavarësia e Kosovës është përmbushje e aspiratave të një shoqërie për liri, aspirata këto të papërmbushura ende për popullin palestinez. I treti është shtetndërtimi si realizimi i detyrave bazike ndërkombëtare për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Pavarësia e Kosovës do të thotë njëkohësisht edhe obligim i institucioneve të vendit për adresimin e nevojave të qytetarëve të saj, nga njëra anë, dhe ruajtjen e sigurisë e stabilitetit për rajonin. Ballkani nuk ka mundur të jetë një regjion stabiliteti pa pasur një formësim shtetesh që marrin përgjegjësi për veten. E njëjta gjë ndodhë me Lindjen e Mesme, regjion më se i trazuar që nuk do të gjejë paqe pa shtetndërtim të suksesshëm. I katërti është përkrahja arabe për një projekt evropian. Pavarësia e Kosovës, në vitet e ardhshme, do të jetë pjesë e rëndësishme e bashkimit të kontinentit. Përkrahja ndaj Kosovës do të jetë një pozicionim më i avancuar i politikës së jashtme të shteteve arabe karshi BE-së.

5.

Por, në përcaktimin e botës arabe rreth çështjes së pavarësisë së Kosovës, mendoj se rol të madh kanë vet Kosova dhe kosovarët, pra politika e ardhshme e vendit tonë.

Për këtë, ja disa sugjerime. I pari, duhet më shumë kuptim. Ndonëse e përdorim si shprehje, nuk ekziston një "botë arabe". Ekzistojnë shtete të ndryshme arabe, me historitë e tyre të veçanta, rregullimet e veta kushtetuese e jetën e tyre ekonomike, qasje të ndryshme ndaj fesë, teknologjisë, Amerikës, parasë.... Duhet t'i njohim shumë më mirë. I dyti, çdonjëri prej këtyre shteteve e kërkon dhe meriton respektin e vet. Njëri prej gabimeve fundamentale të institucioneve të Kosovës është të nënkuptuarit se arabët do ta përkrahin Kosovën me automatizëm, apo edhe më fundamental, se përkrahjen arabe për Kosovën do ta diktojnë fuqitë e mëdha perëndimore, në radhë të parë SHBA-të. I treti, duhet eliminuar paragjykimet. Në javët e fundit, në një gazetë proqeveritare janë bërë dy paraqitje jointeligjente përplotë paragjyke për arabët, dhe marrëdhënien e Kosovës me arabët. Në këto dy artikuj mendjeshkurtër është konstatuar se arabët nuk kanë shoqëri civile, se rolin e intelektualit e ka hoxha dhe për më tepër, sot në botën arabe praktikohet një islam i pafe. Një qasje e këtillë, në të cilën triumfon injoranca njëkohësisht manifestohet edhe trajtimi i shoqërive arabe si të padenja për komunikim me Kosovën. Me këso paragjykimesh, është e tepërt të thuhet, nuk mund të zhvillohet një dialog, e lere më të kërkohet përkrahja. I katërti, Kosova duhet të ndërtojë një qasje afatgjate

ndaj shteteve arabe, përtej nevojës imediate për njohje. Kjo qasje afatgjate duhet të përcaktojë pikat kardinale ku duhet identifikuar interesat e Kosovës, në mesin e të cilave edhe:

- a) dialogu për Islamin dhe avancimi i mëtejshëm i mendimit tolerant brenda Islamit
- b) efektet kredituese të fuqizimit të vendeve eksportuese të naftës
- c) kyçja në tregjet gjithnjë e më të fuqishme të Lindjes së Mesme

6.

Pas njëqind vjetësh, shtetndërtimi është fjala kyçe si në botën arabe, ashtu edhe për Kosovën. Pas një periudhe kaq të gjatë, kemi shumë nevojë për një ndihmë të ndërsjellë në këtë proces historik.

RIDWAN AL-SAYED

Këshilltar i Kryeministrit Libanez Fouad Siniora, Liban

Ne, një grup studiuesish, intelektualësh dhe gazetarësh të ardhur nga disa vende arabe po marrim pjesë në këtë konferencë të organizuar nga "Forumi 2015": "Kosova dhe Bota Arabe" para së gjithash për këto dy qëllime: për t'u solidarizuar, në kuptimin që ne ia dimë vlerën që ka kjo përvojë e re dhe mendojmë se do të ketë ndikime edhe te ne arabët dhe përgjithësisht te shtetet e tjera të botës se tretë, dhe për të nxjerrë mësim nga kjo përvojë e re se si ndërtohet sistemi i një shteti në kontekstin e ri në të cilin janë vënë shtetet pas mbarimit të Luftës së Ftohtë.

Për t'ia filluar, dua të lidhem me mendimin e kolegut tim Veton Surroi që thotë se ne shqiptarët dhe arabët i bashkëpërjetojmë pasojat e një momenti të përbashkët që sipas tij është momenti i shpërbërjes së Perandorisë Osmane, edhe unë besoj që bashkëpërjetojmë pasojat të një momenti të përbashkët, por ky moment kujtoj të jetë përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe jo shpërbërja e Perandorisë Osmane.

Për të argumentuar mendimin që dhashë më lart le t'i bëj një përshkrim të shkurtër historik:

Lufta e Parë Botërore çoi në shpërbërjen e dy perandorive, Perandorisë Osmane dhe Perandorisë Austro-Hungareze, mund të çonte gjithashtu edhe në shpërbërjen e Perandorisë Ruse dhe kështu të shpërbeheshin gjithë perandoritë shumëkombëshe, por kjo nuk ngjau. Nuk ngjau, sepse revolucioni komunist solli një sistem të tillë diktatorial në të cilin kombit rus iu dha udhëheqje dhe sundim mbi kombet e tjera përbërëse të asaj perandorie. Rusia tutje u stabilizua edhe më shumë pasi doli fituese në Luftën e Dytë Botërore.

Në fund të viteve të katërdhjeta, siç dihet, nisi lufta e ftohtë dhe me t'u nisur kjo luftë u ngurtësuan rezultatet që arritën fuqitë që dolën fituese dhe u ngurtësuan të gjitha zhvillimet botërore, prandaj shtetet arabe dhe popujt e Ballkanit nuk mundën të përfitonin nga lëvizja çlirimtare nga okupimi. Lufta e ftohtë ngurtësoi rezultatet e Luftës së Dytë Botërore dhe kur në vitet e pesëdhjeta nisi lëvizja çlirimtare në Afrikë, Azi dhe në Amerikën Latine, nga kjo lëvizje nuk përfituan as arabët dhe as popujt e Ballkanit pikërisht për shkakun se në vendet e tyre ushtronin sundimin ata që nxitnin lëvizjen çlirimtare nga okupimi dhe që kishin dalë fitues në Luftën e Dytë Botërore, sado që njëri nxitës ushtronte sundimin në Ballkan kurse në Lindjen e Mesme nxitësi tjetër.

Tani që ka përfunduar Lufta e Ftohtë ne arabët dhe ballkanasit bashkëjetojmë pasojat e momentit të përfundimit të kësaj lufte dhe të asaj bote që e përcaktoi Lufta e Dytë Botërore dhe që më pas e la të njëjtë Lufta e Ftohtë.

Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, në Ballkan, Azi të Mesme dhe Kaukaz, ndryshe nga vendet arabe, zhvillimet morën hov për shkak të zgjuarsisë së popujve të këtyre vendeve dhe për shkak të mundësisë që iu krijua për të kërkuar të drejtat, liritë dhe pavarësinë. Këto vende kishin hequr keq dhe u ishin bërë padrejtësi të mëdha gjatë katër shekujve nga perandoritë e mëdha dhe nga shtetet mesatarisht të fuqishme si Perandoria Austro-Hungareze, Perandoria Osmane, Perandoria Ruse dhe

pastaj shteti mesatarisht i fuqishëm serb. Padrejtësitë te këta popuj nxitën ndjenjën kombëtare dhe prandaj mezi që pritën t'u vinte momenti për të kërkuar të drejtat, lirinë dhe pavarësinë. Këto zhvillime ende nuk kanë ngjarë te ne arabët, ende jemi në pritje të këtyre zhvillimeve.

Shkaku pse te popujt e Ballkanit kanë ngjarë e te ne jo këto zhvillime qëndron në këto dy fakte: 1. Kërkimi i të drejtave dhe i lirive te popujt e Ballkanit është lidhur fatmirësisht me kërkesën për demokratizim të sistemit qeverisës, kurse shtetet kryesore arabe formalisht ishin të pavarura dhe në to lufta e ftohtë ngurtësoi një sistem udhëheqjeje diktatoriale, i la në pushtet po ata qeveritarë ushtarakë që nisën pas Luftës së Dytë Botërore ta ushtrojnë pushtetin në emër të nacionalizmit arab dhe në emër të çlirimit të Palestinës pa bërë deri më sot as edhe një të mirë për popujt e vet. 2. Shteti i cili ushtron ndikimin në vendet tona është Amerika dhe kjo gjë ende nuk ka ndryshuar, pra Amerika vazhdon ta ushtrojë ndikimin edhe sot e kësaj dite dhe prandaj nuk nxit ndryshimet në sistemin e udhëheqjes arabe që është ende sistem diktatorial që mbeti i njëjtë gjatë gjithë kohës sa zgjati Lufta e Ftohtë dhe fatkeqësisht vazhdon edhe tani, sepse, siç përmendëm, ai që ka ushtruar ndikimin gjatë Luftës së Ftohtë vazhdon po i njëjti ta ushtrojë edhe sot e kësaj dite te këto shtete arabe të cilat formalisht mbaheshin si pro-ruse por që realisht punonin për interesa amerikane.

Ne arabët pra ende jemi në pritje të zhvillimeve që tashmë kanë ngjarë te ju, zhvillime që i japin hov progresit dhe procesit demokratizues të sistemit qeverisës. Pas kësaj paraqitjeje përmbledhtazi të rrethanave të përgjithshme që mbretërojnë te ju dhe te ne, kërkoj të mos habiteni pse shtetet arabe ende nuk jua kanë pranuar pavarësinë e vendit tuaj.

Duhet të shpjegohet se për zhvillimet që kanë ngjarë te ju, arabët varësisht prej niveleve që përfaqësojnë kanë perceptime të ndryshme. Në rrafshin popullor këto zhvillime kanë gëzuar përkrahje të jashtëzakonshme. Thua se në të gjitha vendet arabe janë organizuar protesta dhe forma të tjera organizimi për të shprehur revoltën kundër veprimeve që ndërmerrete kundër jush dhe më parë kundër boshnjakëve Serbia. E di, drejtpërdrejt, si dëshmitar, që shumë janë burgosur nga këta protestues, madje disa nga ta revoltën e kanë shprehur edhe në forma ekstreme, sepse thjesht populli ishte i vetëdijshëm se e drejta ishte në anën tuaj.

Sa i përket perceptimit të qeverive arabe puna afërmendsh që qëndron ndryshe. Unë personalisht kam prezantuar në Takimin e Ministrave të Jashtëm Arabë në Ligën Arabe kur është marrë vendimi që të shtyhet çështja e njohjes së shtetit të Kosovës, gjithashtu bashkë me Kryeministrin Fouad Siniora kam marrë pjesë në mbledhjen e Konferencës Islame kur është diskutuar çështja e njohjes së shtetit të Kosovës. Duhet të dihet se nuk është i mirëfilltë shkaku që është përmendur si pretekst se shtetet arabe nuk pranojnë pavarësinë e Kosovës pse nuk duan t'i prishin marrëdhëniet me Rusinë e me Serbinë. Po ashtu nuk është i vërtetë as shqetësimi që është përmendur gjithashtu si pretekst i mosnjohjes se shtetet arabe paskan frikë mos po bëhet zgjidhja që është dhënë për Kosovën precedent për t'u zgjidhur ashtu disa probleme në botën arabe e kjo nuk do t'u konvenonte atyre. Ky shqetësim i rremë e i përmendur si pretekst për mosnjohje nuk qëndron, sepse mbi 90% e banorëve të shteteve arabe janë të etnisë arabe që e kanë arabishten gjuhë amtare dhe gjithashtu mbi 90% i përkasin fesë islame, pra në botën arabe nuk ka raste dualiteti as etnik e as fetar aq problematik sa ka në shtete të tjera joarabe

të cilat ky fakt nuk i ka penguar ta njohin shtetin e Kosovës, pra nëse dikush do të shqetësohej për këtë gjë do të duhej të shqetësoheshin ato shtete e jo shtetet arabe të cilat, siç thamë, nuk kanë raste të theksuara dualizmi as etnik e as fetar, përjashtoj Irakun i cili vërtet ka problemin me kurdët.

Shkaku i vërtetë pse arabët janë vonuar ta njohin pavarësinë e Kosovës është thjesht ky: qeveritarëve arabë nuk u pëlqen që një popull të luftojë luftë, siç thuhet në terminologjinë majtiste, çlirimtare, të shpallë pavarësinë megjithë mospranimin e shtetit që më parë e ka sunduar dhe që pastaj menjëherë me të mbaruar lufta - çka është shkaku i këtij mospëlqimi, - në atë vend të ngrihet jo sistem ushtarak por sistem demokratik popullor i mbështetur në zgjedhje e në vlera të tjera demokratike. Këtë nuk mund ta pranojnë qeveritë arabe dhe pikërisht këtu qëndron shkaku pse ngurrojnë ta pranojnë pavarësinë e Kosovës.

Nëse pranojmë realitetin e ri në Kosovë dhe nëse analizojmë mirë mënyrën si është zgjidhur çështja e Kosovës, ne arabët kemi 5 interesa:

1. E drejta e vetëvendosjes së popullit palestinez. Megjithëse ka pasur vendime ndërkombëtare, konflikt të armatosur dhe 7 a 8 luftëra, nuk kemi arritur ta largojmë Izraelin të paktën nga 22% e tokës së Palestinës që vazhdon të ketë shumicë absolute palestineze. Kryetari Bush çdo ditë krenohet para nesh se është i pari që është deklaruar për dy shtete, por, megjithëse problemi ka 60 vjet, asgjë nuk është ndryshuar lidhur me Palestinën. Arabët do të duhej që të pranonin realitetin e ri në Kosovë dhe t'u a tërhiqnin vëmendjen Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve evropiane që kanë ndihmuar edhe me forcë Kosovën që sipas po kësaj përvojë të re t'i gjenin zgjidhje edhe çështjes së Palestinës.

2. Shtrirja kulturore. Vërejmë se si Franca e Britania ndërtojnë bashkë me shtetet që kanë invaduar liga me kuptim më shumë kulturor sesa politik, kurse ne arabët ka kohë prej kur nuk vijojmë ndonjë strategji të mirëfilltë të shtrirjes së kulturës sonë. Kur vërejmë se këto vende si Kosova janë të hapura ndaj nesh pse të mos jemi dhe ne të hapur ndaj tyre.

3. Islami evropian. E di që ky term fillimisht është vënë në përdorim për qëllime negative në kuptimin që të paraqitet se Islami ka kudo karakteristikë fundamentalizmin të cilin pritej ta shfaqnin komunitetet myslimane që kishin migruar në Evropë nga Turqia, Pakistani e vendet arabe. Ky term pastaj mori kuptim të ri që duhet të jetë sipas meje sot më thelbësori e ky kuptim është që ka evropianë autoktonë që kanë pranuar fenë islame, që nuk ndjehen si pakicë sepse janë evropianë burimorë, këta kanë një përvojë të ndikuar nga përvoja evropiane për ndërtimin e shtetit, për raportin ndërmjet fesë dhe shtetit dhe ndërmjet fesë dhe kombit dhe nga e cila përvojë mund të përfitonim shumë ne të vendeve të Arabisë Lindore ku kemi problem me fundamentalizmin fetar që kërkon të ndërtojë shtet fetar. Vërtet në Turqi ka disa shfaqje të këtij islami evropian, por rrethanat në këto vende na janë më të përafërta me rrethanat e vendeve tona të Arabisë Lindore sesa që na janë rrethanat në Turqi. Ne mund të përfitonim nga kjo përvojë e re shumë sidomos në aspektin e demokracisë së institucioneve, në aspektin e marrëdhënieve fe-shtet dhe marrëdhënieve shtet- komb.

4. Rigjallërimi i marrëdhënieve kulturore dhe fetare. Dihet që ne kemi pasur përgjatë shekujve të tërë marrëdhënie të ngjeshura kulturore e fetare qoftë gjatë kohës

së Perandorisë Osmane qoftë jashtë saj, në kohëra që vazhdojnë të jenë ende në mendjen dhe në kujtimin e mirë të studiuesve të këtyre fushave. Këto marrëdhënie besoj që është në interesin e të dyja palëve që të studiohen, të rigjallërohen dhe të përtërihen.

5. Për pasuritë e shumta që gjendet ndër arabë këta dhjetë e fundit si kurrë më parë e për të cilat kanë problem të gjejnë ku t'i investojnë, Kosova do të ishte vend ideal. Jo vetëm qeveritë arabe, por edhe kapitalistët arabë veç e veç do të mund të investonin. Kam folur me disa afaristë arabë dhe kam vërejtur që një pjesë e madhe e tyre nuk dinë se Kosova mund të jetë vend investimi i tyre i frytshëm, pranimi i pavarësisë nga disa apo nga të gjitha qeveritë tona sigurisht që do t'i nxiste ata për të investuar në Kosovë.

Duke e përfunduar kam dëshirë të theksoj se detyrë jona e përbashkët është që arabët t'i njohim sa më mirë me këto vende të bukura e me këtë popull të mrekulluar, me përvojat e tyre dhe me domosdonë e interesin që të kemi sa më shumë lidhje, kurse ju si qeveri dhe shoqëri civile keni për detyrë që të ngrini zërin edhe më shumë dhe t'i shtoni zërat që flasin për ju në botën arabe.

MUHAMET MUSTAFA

Instituti RIINVEST

Te nderuar pjesëmarrës, më lejoni që të hap panelin e parë të konferencës "Kosova dhe bota Arabe" i cili ka për qëllim të bëjë një trajtim problemit të ndërtimit të shtetësisë së Kosovës, kontinuitetit të rrethanave të veçanta historike që kanë sjellë të ky proces i gjatë dhe i vështirë dhe sidomos të përqendrohet në kushtet dhe sfidat aktuale me të cilat përballlet ky proces pas shpalljes së pavarësisë dhe apropvimit të Kushtetutes së Kosovës. Njëra nga çështjet më sfiduese për shtetndërtimin në Kosovës sot është forcimi sa më i shpejtë i pozicionit ndërkombëtar dhe anëtarësimi i shtetit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare duke përfshirë edhe anëtarësimin në OKB. Progresi i arritur me njohjen e pavarësisë nga 46 shtete, pothuajse nga të gjitha kontinentet duhet të fuqizohet me ritme me të shpejta të njohjes edhe nga vendet e tjera për ta arritur këtë objektiv në një periudhë sa më shkurtër të mundshme. Derisa mund të jemi të kënaqur me pranimin e pavarësisë për shembull nga vendet e Bashkimit Europian (21 nga 27) dhe nga SHBA dhe me raportin e shumcës së fqinjëve tanë, rezultatet e arritura në disa pjesë të botës, e veçanërisht në vendet arabe dhe islame për shumë kend paraqesin befasi. Mirëpo po të shihet me kujdes ky problem del se një spektër rrethanash që lidhen të shumtën me mungesën e kuptimit të kushteve sui generis të shtetndërtimit të Kosovës dhe mungesën e komunikimit në relacionin Kosova – Bota arabe janë dy shkaqet themelore që kanë ndikuar në këtë ngecje. Disa nga këto shkaqe janë identifikuar edhe në Konferencën që organizuan Forumi 2015 dhe Qendra Al Quds në Amman më 12 Korrik të këtij viti.

1. Edhe pse shumica e pjesëmarrësve të tubimit në Amman (ku moren pjesë 60 intelektualë, analiste, shkrimtarë, deputetë dhe përfaqësues partishe politike) ishin në favor të njohjes sa më të shpejtë të pavarësisë së Kosovës nga vendet arabe, një numer diskutuesish shtronte pyetjen se a thua pavarësia e Kosovës është e drejtë dhe fer (Just and Fair) duke u përcjellë edhe me opservimet se " Kosova i është shkëputur Serbisë dhe është krijesë e Perëndimit " për tu përdorur edhe gjetiu e dhe në vendet Arabe për të rrezikuar integritetin e tyre. Këto opservime për Kosovaret mund të duken të çuditshme kur edhe nga bota arabe ne kemi pasur një solidaritet dhe mirëkuptim gjatë luftës dhe ndihma humanitare gjatë fazes së evitimit të pasojave të luftës. Mirëpo nuk duhet harruar se nga ajo situatë dramatike na ndajnë gadi 10 vite, dhe ne botën e sotme dinamike kënaq ndodhur shume ngjarje e zhvillime me probleme gjeostrategjike te vjetra dhe te reja. Një konkluzë elementare qe del është se në këtë pjesë të botës ka nevojë edhe njëherë të prezantohet konteksti i krijimit të shtetësisë së Kosovës historikisht dhe sidomos në dekadën e fundit të shekullit të kaluar i cili kulmoi me luftën në Kosovë dhe pasojat e saj tejet të rënda. Pa hyrë më thellë në aspektin historik duhet të theksohet se shtetësia e Kosovës del nga e drejta e natyrshme e popullit të Kosovës që të vendos për fatin e vet, për liri dhe pavarësi dhe ndërtim të shoqërisë demokratike pas shkatërrimit të shtetit federativ ku Kosova ishte entitet i barabartë me entitetet (si Slovenia, Kroacia, Bosna, Maqedonia e tjera) pavarësia e të cilave tani është njohur nga vendet arabe. Procesi i pavarësimit të Kosovës nuk ka asgjë të përbashkët me atë se dikush me dhunë i ka shkëputur Kosovën Serbisë, përkundrazi Serbia okupoi Kosovën pas shkatërrimit të perandorisë turke dhe e rikupoi atë, duke shkelur kushtetuten federative të vitit 1974, në tendencat e saj për të dominuar në ish Jugosllavi dhe për të krijuar "Serbinë e madhe" e që solli shkatërrimin e të ashtuquajturës "Jugosllavi

e Titos" nëpërmjet luftave të përgjakshme në Slloveni e sidomos në Kroaci, Bosne dhe Kosovë. Kosovarët ju përgjegjen riokupimit të vrahde nga Serbia me rezistencë aktive paqësore e më vonë edhe me luftë të armatosur, kurse intervenimi i NATO-s dhe bashësisë ndërkombëtare ishte përgjegje ndaj apërthidit, vrasjeve masive, deportimeve të popullatës, shkatërrimeve të mëdha dhe rezikut evident të gjenocidit. Kjo situatë sui generis duhet të kuptohet më drejtë edhe sot, sidomos në botën arabe, për të ngushtuar hapësirën e ndikimit të propagandës agresive të shtetit rus dhe atij serb, i cili tenton ta injorojë këtë konjekt dhe të kercnohet me precedentin e Kosovës për ta përdorur për nevoja të reja gjeostrategjike. Pra konteksti i pavarësisë së Kosovës ka vecantite e tij dhe nuk është i karasueshem me problemin me të cilat sot ballfaqohet edhe bota arabe.

2. Fakti se Kosova është një vend European me shumicë të madhe të popullsisë muslimane, që ndërton institucionet demokratike të shoqërisë përpale dhe ekonominë e tregut, ku islami koegziston me praktikën demokratike dhe shoqërinë civile e bën Kosovën një vend interesant, si model të ndërtimit të shoqërisë demokratike, një shtet laik, në koegzistencë me parimet islamike që paraqesin pjesë të identitetit dhe kultures religjioze të pjesës dermuese të popullatës. Në diskutimet që kam pasur me shumë intelektualë dhe liderë të shoqërisë civile nga vendet arabe kjo është një përvojë shumë interesante dhe këmbimi i përvojave në këtë plan me shoqërinë civile, qarqet akademike, kulturore dhe institucionale është me interes të madh për të dy palët. Multikulturalizmi dhe toleranca fetare në Kosovë dhe të shqiptarët një veçanti është një kapital social shumë i rëndësishëm i cili përbën esencën e harmonisë shoqërore dhe sociale në shtetin e Kosovës. Konflikti në Kosovë me hegjemonizmin dhe shovenizmin serbomad nuk ka pasur karakter religjioz. Ai parasegjithash ka pasur karakterin e çlirimit nacional dhe shtetndërtimit, megjithatë shqiptarët janë dënuar dhe anatemuar edhe përshkak besimeve të tyre muslimane dhe katolike me shkatërrimin e këtyre vlerave, dhunen ndaj kësaj trashigimie e monamenteve dhe anatemimit të tyre si fudamentaliste nga propaganda shterore serbe (ku janë bashkuar institucionet shtetërore, akademja dhe kisha ortodokse). Akteret e kësaj propagande në perëndim zhvillojnë fushatë se gjoja krijimi i shtetit të Kosovës rrezikon civilizimin perëndimor, kurse paktimi special i kësaj propagande për vendet arabe është se Kosova është krijese fuqive perëndimore për të shkatërruar integritetin e shteteve arabe e gjetiu në lindje. Kosova për shkak të voneses në ndërtimin institucioneve të saj por edhe për shkak të anagzhimit të pamjaftueshëm deri tani nuk ka prezentuar mjaftë informata ndaj botës arabe. Kontaktet kanë qenë të neglizhuara dhe të pamjaftuara dhe kjo situatë duhet të korigjohet shpejtë. "Forumi 2015" ka inicuar një projekt për të dhënë kontribut në ndërtimin e imazhit pozitiv në botë, e në këtë kuader ka inicuar edhe këtë bashkëpunim me partnerë në botën Arabe. Konferenca e sotme është vazhdim i debatit të Ammanit, pothuajse në temën e njëjtë, ndërsa ky panel presim të shkojë më tutje në elaborimin e çështjeve që unë i shtrova si hyrje e këtij diskutimi. Për këtë kemi një listë impresive prezentesish dhe diskutuesish.

MUHAMEDIN KULLASHI

Universiteti Paris 8

Lidhur me temën e laicizmit në Kosovë, do ta marr në konsiderim tezën e përhapur gjatë disa viteve, në disa qarqet politike e intelektuale të Beogradit, të përvetësuar pastaj edhe nga mediat e disa vendeve të tjera: sipas kësaj teze rreziku kryesor që do të dilte nga Kosova e pavarësuar, për Ballkanin dhe Europën, qëndron në faktin se ajo do të bëhej një bazë e integritetit islamist dhe terrorizmit ndërkombëtarë, duke shërbyer si urëkaluese midis Bosnjës e Turqisë dhe Lindjes së afërt. Kjo tezë zhvillohej në versione të ndryshme, ndërthurej me teza të tjera për rreziqet nga « separatizmat » e minoriteteve në mbarrë rruzullin tokësor. Ligjërimet e tilla politike, që prodhohin përfytyrime e efekte të caktuara politike për Kosovën, vlen të ballafaqohen me rrjedhat konkrete historiko-politike, me realitetin e ngjarjeve që kanë karakterizuar së paku dy decenitë e fundit në Ballkan. Edhe nga një analizë krejt e sipërfaqshme politike e këtyre ngjarjeve do të mund të hetohej karakteri mistifikues i tezave të përmendura. Madje, sikur të merren në konsiderim vetëm burimet zyrtare të Sërbisë do të vërehej se konflikti midis regjimit serb dhe shqiptarëve të Kosovës nuk ka qenë konflikt ndër-fetar por konflikt thelbësisht *politik* midis shtetit serb dhe lëvizjeve politike të shqiptarëve. Ky konflikt ka marrë trajta gjithnjë e më të ashpëra, në veçanti nga fillimi i viteve të 80, dhe është konflikt i cili përmbledhë në vete krizën e shumfishtë politike të federatës jugosllave. Mirëpo, nga të gjitha raportet zyrtare të Sërbisë mbi këto konflikte vërehet qartazi se të gjithë aktorët politik të shqiptarëve të Kosovës, duke filluar nga grupet ilegale e deri te partitë politike që lindën në vitet 90, kishin kërkesa e programme kryekput *politike*, të zhveshura nga elementet fetare. Në fakt, *kundërthënia* midis këtyre raporteve dhe burimeve zyrtare mbi ngjarjet konkrete dhe ligjërimi që më vonë, për nevoja të opinionit ndërkombëtar, synonin t'i paraqesin shqiptarët si islamistë të rrezikshëm, ishte evidente. Kjo bëhej edhe më qartë në analizat e vëzhguesëve dhe hulumtuesëve nga vende të tjera që mirreshin me problemin e Kosovës.

Historianët e historisë politike, në veçanti si edhe shumë politologë të Ballkanit, e vendosin fenomenin e përmendur brenda një horizonti më të gjerë historik. Në analizat krahasimtare të raporteve *politika-religjioni*, *shteti-kisha* në vende të ndryshme të Ballkanit, theksohet një dallim i dukshëm midis këtyre raporteve të shqiptarët dhe të sërbit. Kësisoj, në hulumtimet e Georges Castellan, Paul Garde, Ivan Djuric, Radmilla Rajic, Rajwantee Lakshman-Lepain, vëhet në pah ky dallim karakteristik: derisa lëvizjet politike shqiptare, që nga shthurja e Perandorisë otomane, afirmonin ndërtimin e lidhjeve politike, përtej dallimeve midis tri feve (islamit, ortodoksisë e katolicizmit), si dhe dallimeve midis fiseve e regjioneve, të sërbit kisha ortodokse do të ketë një rol të theksuar politik në mobilizimin e masave me ligjërimi religjioze-politike. Këta hulumtuesë konstatojnë se multikonfesionalizmi është pjesë përbërse e identitetit kombëtar të shqiptarëve, përderisa të sërbit ortodoksia lidhet me përkufizimin e kombit. Këta kanë përmendur shumë shembuj konkret nga kjo qasje laiciste e lëvizjeve dhe partive politike të shqiptarëve. Fjala vjen, ngjarjen ngjarjen nga viti 1924, në Shqipëri, masat popullore, me shumicë muslimane, e përkrahën ardhjen në pushtet të Fan Nolit, i cili ishte edhe ipeshkv i kishës ortodokse. Mirëpo, Noli perceptohej në opinionin shqiptar para së gjithash si figurë politike e çmuar, si figurë që ka parasysh interesin kombëtar të shqiptarëve, e kjo nënuptonte një lidhje politike përtej dallimeve fetare të shqiptarëve.

Natyrisht, në këtë histori politike, qasja e regjimit komunist të Enver Hoxhës, nuk ka të bëjë fare me laicizmin, por me një shkelje brutale të drejtave elementare të besimtarëve të të tri feve të shqiptarët, shkelje kjo që ishte një aspekt i mohimit të drejtave të njeriut në Shqipëri, përfshirë këtu edhe liritë politike.

Te sërëbët, ndërkaq, roli politik i kishës dhe fesë ortodokse do të merr trajta vendimtare veçmas nga fillimi i viteve 80, pra në kohën e nismës së mbarimit të Jugosllavisë federale, dhe pikërisht karshi çështjes së Kosovës, më saktësisht rreth instrumentalizimit politik të një kujtese historike. E kam fjalën për mitologjinë politike të ndërtuar lidhur me betejën e Kosovës së vitit 1389 dhe për përdorimin e saj në krizën politike të Jugosllavisë. Një aspekt i kësaj krize u shpalosë në mitingjet masive populiste, të organizuara nga regjimi i Miloseviçit dhe fortësisht të mbështetura nga kisha ortodokse, tema kryesore e të cilave do të jetë Kosova e paraqitur si një kompleks teologjiko-politik.

Ngjitja e Milosevic në pushtet (1987) përputhet me krizën e sistemit jugosllav: kundrejt të metave të një sistemi jo-demokratik, ndaj krizës ekonomike dhe grindjeve të oligarkive të njësive federale, elitat politike e intelektuale në Sërbi, në vitet 80, do të përgjigjen me një program populist-nacionalist i cili do ta merr në shenjestër një aspekt të sistemit i cili, në krahasim me Jugosllavin e parë (1918-1941), mund të shikohet deridikund si pozitiv: pranimin institucional e politik të diversiteteve të kulturave e gjuhëve si dhe faktin se pushteti federal sajohej me delegimin nga njësit federale. Ideologët e kësaj lëvizje nacionaliste do të ndërtojnë një rëfim për « tradhëtinë » ndaj Sërbisë nga njësitë tjera federale, për « strategjitë dhe komplotet anti-serbe ». Idetë e këtij programi nacional, në sajë të një teknologjie të prodhimit të paragjykimëve dhe urrejtjes ndëretnike e ndërfetare, përhapeshin nëpër media e mitingje masive, por edhe në revista letrare e shkencore.

Lidhëmërinë midis aspektit religjioz dhe atij politik brenda kësaj lëvizje do ta ilustronja shkurtazi me dy ngjarje. Midis qershorit të vitit 1988 dhe qershorit 1989 (që shënonte 600 vjetorin e betejës së Kosovës), u zhvillua një manifestim politiko-religjioz, i përsëritur nëpër krahina të banuara me serbë në Kroaci, Bosnje-Hercegovinë dhe në Kosovë: ishte fjala për një ceremoni të shetitjes së eshtrave të car Lazarit (i cili u pat vra në betejën e Kosovës me 1389), nëpër këto krahina, si dhe për mbajtjen e ligjërimeve politiko-religjioze (nga priftinjtë, politikanët dhe artistët), në disa fshatëra e qytete ku evokoheshin edhe ngjarjet nga Lufta e dytë botërore, përkatësisht krimet e bëra kundër sërëbëve. Me atë rast, shpaloseshin edhe eshtrat e zhvarosura të viktimave të kësaj lufte. Letra përcjellse e këtij kortezhi, e cila lexohej gjatë këtyre ceremonive, veç tjerash përmbante edhe këtë porosi që i drejtohej, siç thuhej, « armiqëve të Sërbisë së përkëgjatur e të martirizuar »: « do të bëjmë gjithëçka që është e mundur për të çrrënjësuar fiset e tyre në mënyrë që historia të mos i përmend kurrë më ». Ndaj kësaj letrë, të botuar në të përditshmen e Beogradit « Politika » (17 shtator 1988), reagoi, veç tjerëve, edhe një funksionar i lart serb nga Bosnja, Miroslav Jançic, duke theksuar rrezikun që përmban porosia e saj.

Ngjarja e dytë është ngusht e lidhur me të parën, ngase ceremonia e përmendur përfundon në Fushë-Kosovë, në një miting gjigant, të organizuar nga regjimi i Miloseviçit. Edhe me këtë rast, u manifestua *lidhëmria midis politikës e religjionit*, shtetit dhe kishës. Para më se një milion vetave, Milosevici mbajti fjalimin i cili, do të analizohet shpesh nga vëzhguesë e hulumtuesë të ngjarjeve dramatike të Ballkanit. Nga ky fjalim do të përmend vetëm dy elemente karakteristike: përkufizimin e Jugosllavisë së II (1945-1991), të cilësuar me sundimin e Titos, si « tradhëti »

të interesave serbe, ndërsa Kosovën si « simbol të kësaj tradhëtie », e në anën tjetër, paralajmërimin e luftërave të armatosura në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Në revista letrare dhe kishtare, këtij cilësimi i shtohet edhe figura e « kalit të Trojës ». Inspirimin për këtë fjalim Miloseviçi e gjeti sa te Memorandumi i Akademisë së shkencave dhe arteve të Serbisë, nga viti 1986, aq edhe brenda ligjëtimeve e zjarra të krerëve të Kishës ortodokse serbe. Njeri nga sloganet e njohura të këtyre ligjëtimeve, i sajuar nga Dobica Cosić, figurë qendrore e Akademisë së shkencave, e më vonë edhe kryetar i Jugosllavisë së III, thoshte shprehimisht: « ne kemi humbur në paqë atë që kemi fituar në luftë ». Kësisoj, në njerën anë Jugosllavia e dytë përkufizohej si suazë e humbjes së interesave të sërbeve, e në anën tjetër cekej nevoja e luftërave të reja për të ripushtuar atë që është humbur. Në ligjëtime të shumta politike e politiko-religjioze gjersisht do të elaborehen këto ide, si ide qendrore të një platforme politike, e cila përgaditit dhe legjitimoi agresionet e njëpasnjëshme ushtarake ndaj Sllovenisë, ndaj Kroacisë, ndaj Bosnje-Hercegovinës dhe ndaj Kosovës, në një interval prej tetë vitesh, me të gjitha pasojat që ju i dini. Këto ligjëtime mund të cilësohen me terma të Michel Foucault-së si «ligjëtime-ngjarje»: ligjëtime që paralajmërojnë ngjarje dhe si të tilla kanë peshën e ngjarjeve. Në anën tjetër, jo rastësisht, Kosova sot, në Kushtetutën e saj përkufizohet si shtet laik. Elitat politike e intelektuale të shqiptarëve të Kosovës kanë gjetur mbështetje lidhur me këtë çështje të raportit politika-feja, sa brenda traditës politike kombëtare aq edhe brenda traditës më të mirë europiane, e cila arriti t'i japë fund luftërave fetare në Europë, pikërisht në saje të kulturës laike, duke e bërë, në njerën anë, ndarjen e shtetit nga kisha, të politikës nga religjioni e në anën tjetër, me modelin e shtetit demokratik, neutral ndaj përkatësive fetare, arriti të siguroj të drejtat dhe liritë e të gjitha bashkësive fetare, qofshin mazhoritare apo minoritare.

Mirëpo, ngjarja e përmendur e vitit 1989 në Fushë-Kosovë ka karakter shpjegues edhe për temën e dytë, atë të multikulturalizmit.

Dhe pikërisht këtu do të bëja kalimin te tema e dytë ajo e multikulturalizmit. Krejt shkurtazi, do ta shtroja një analogji, lidhur me këtë çështje, midis përvojave teorike e politike të vendeve perëndimore dhe atyre të Europës juglindore, gjegjësisht të Ballkanit.

Multikulturalizmi

Për hirë të saktësismit te domethënies së termit « multikulturalizëm », shpesh bëhet dallimi midis tre niveleve: social, politik dhe filozofik. Multikulturalizmi lidhet me shumësinë e kulturave si realitet i shoqërive moderne, realitet që del nga një evolim social i cilësuar me rritën e dukshme të dallimeve kulturore, dallime këto që gjejn shprehje brenda tipologjive të ndryshme të diversiteteve kulturore.

Termi multikulturalizëm paraqitet shprehimisht në kontekstin politik të Kanadasë (në mbarim të viteve 70), aty ku u artikulua ideja e kombit kanadez si një komb multikulturor, i sajuar jo vetëm nga dy popujt themelues por edhe nga tërësia e imigrantëve. Me 1982, multikulturalizmi u ngrit në Kanada në parim kushtetues, i cili afirmon idenë se barazia qytetare është e pajtueshme me respektimin e dallimeve kulturore. Në këtë mënyrë, zyrtarisht shënohet shkëputja nga modeli asimilacionist, i cili mbisundonte në shumicën e vendeve demokratike e sipas të cilit integrimi politik varet nga përvetësimi i normave kulturore të shumicës. Konkretisht, kjo do të thotë se zbatohen masa politike e juridike që kanë për qëllim t'u garantojnë pakicave

etnike një barazi të trajtimit atëherë kur normat në fuqi nuk u janë të favorshme. Politikat multikulturaliste nuk kufizohen vetëm në përshtatjen e ligjeve nga gjyqet, por shprehin poashtu një spektër të tërë të masave politike që kanë për synim të ndihmojnë integrimin e imigrantëve (fjala vjen, programi affirmative action në fushën ekonomike e arsimore, që nënkupton një përfaqësi politike specifike, kurse për gjuhën e pakicave etj.).

Në Australi, Britani të Madhe, Zvicër dhe Holand janë zbatuar politika të ngjashme, ndonëse multikulturalizmi nuk është ngritur në parim kushtetues. Megjithatë, për këto vende mund të thuhet se kanë zbatuar atë që M. Wieworka quan « multikulturalizëm i integruar », i ndryshëm nga « multikulturalizmi i shpërthyer » (éclaté) në SHBA. Në rastin e parë, politikat multikulturaliste synojnë shprehimisht të promovojnë respektimin e diversitetit kulturor në sajë të një forme të pranimit (njohjes) publike. Në rastin e dytë është më shumë fjala për luftimin e para gjykimeve raciste.

Zbatimi i politikave multikulturaliste ka qenë i shoqëruar me debate e polemika politike e filozofike të dendura. Në veçanti është shquar debati kritik rreth teorisë liberale të situajnetetit (*citizenship*) apo qytetarisë, në kuptimin politik, polemikat midis komuntaristëve dhe liberalëve, ose edhe polemikat midis modelit të një shoqërie të përbërë nga një shumësi komunitetesh dhe një shoqërie të përkufizuar thelbësisht me qytetarinë (*citizenship*), ose me modelin republikan të kombit. Këto polemika morën edhe trajtën e kundërvënies midis situajnetetit dhe qytetarisë multikulturore (*multicultural citizenship*).

Mbrojtja e idesë multikulturaliste është artikuluar, shpesh, si kritikë e «univerzalizmit abstrakt», përkatësisht e paaftësisë së tij që të garantojë pavarësinë politike të individëve që kanë identitete dhe mënyra të të jetuarit të ndryshme, identitetet minoritare. Përfaqësuesit e këtij orientimi (si Iris Marion Young), mbrojnë mendimin se univerzalizmi i mirrëfillt duhet të favorizojë përfaqësinë politike të grupeve të mbisunduara në mënyrë që perspektivat të integrohen në procesin e debatit politik. Ndërkaq Charles Taylor (në artikullin e njohur "Politika e pranimit" mbron politikën multikulturaliste lidhur me pakicat etnike, në veçanti të drejtën e përdorimit të gjuhëve të pakicave. Ai kritikon "republikën procedurale" dhe "liberalizmin e të drejtave" në atë masë sa këto përjashtojnë promovimin e identiteteve kulturore të pakicave; në mbështetje të një nocioni modern të së drejtës, i cili merr parasysh sa vlerën univerzale të dinjitetit (të individit) aq edhe vlerën specifike të autenticitetit, mëvetësisë kulturore.

Will Kymlicka (në *Liberalism, Community and Culture*) zhvillon idenë e "situajnetetit multikulturor" (*Multicultural Citizenship*) dhe idenë se liberalizmi politik duhet t'i përgjigjet sfidës së multikulturalizmit. Sipas tij, nëse shteti mund të jetë neutral në pikëpamje konfesionale, ai nuk mund të jetë neutral në pikëpamje kulturore; shteti promovon vazhdimisht kulturën e shumicës, në dëm të kulturave minoritare, nëpërmjet zgjedhjes së një gjuhe zyrtare, të simboleve kombëtare, të festive fetare etj. Është fjala për formulimin e të drejtave kulturore që mund të vendosin barazinë midis grupeve mazhoritare dhe atyre minoritare. Teoria e situajnetetit multikulturor bën dallimin midis pakicave kombëtare (të formuara pas një pushtimi apo aneksimi) dhe pakicave etnike, të sajuara nga imigrimi. Të parat mund të pretendojnë në një shkallë të vet-qeverisjes, në mënyrë që të kontrollojnë vendimet politike që kanë të bëjnë me ardhmërinë e kulturës së tyre (gjuha, arsimi etj.)

Të drejtat kulturore kuptohen këtu si « mbrojtje të jashtme (*external protections*) që synojnë të vendosin barazinë midis grupeve, dhe këto nuk implikojnë, siç theksojnë disa liberal, vendosjen e “kufizimeve të brendshme” (*internal restrictions*), që synojnë të kufizojnë lirinë e pjestarëve të një minoriteti. Teoria e Kymlickas konsiderohet si versioni më i zhvilluar i mbrojtjes liberale të multikulturalizmit. Disa liberalë, si Joseph Raz, nuk ndalen vetëm te një arsytim politik i multikulturalizmit por e shikojnë këtë si shfaqje të një senzibiliteti të ri moral, të një vetëdije identitare refleksive dhe e hapur ndaj shumësisë së kulturave.

Këto orientime politike e intelektuale kërkojnë që barazia e përgjithshme para ligjit të kompensohet me një sistem të mbrojtjeve specifike, në sajë të një parimi të diferencuara me një ide të barazisë që shikohet si më e lartë.

Kritikat e multikulturalizmit, ndërkaq, janë zhvilluar në versione të ndryshme, më të buta a më të ashpëra. Kështu, Brian Barry në *Culture and Equality* (*Kultura dhe Barazia*, 2001) kritikon qëndrimin kritik të multikulturalistëve ndaj idealit universalist, të trashëguar nga iluminizmi i shekullit XVIII. Sipas tij, duke e ngritur praktikën e *rule and exemption* (regulla dhe përjashtimi) në rangun e një modeli politik, në mënyrë që të sendërtohet “situaenëtetit i diferencuar”, multikulturalistët e kompromitojnë kuptimin e barazisë së qytetarëve para ligjit. Në këtë mënyrë, sipas tij, multikulturalizmi favorizon një klientelizëm politik dhe rënon bazat e solidaritetit civil, e nuk promovon një formë më të lartë të barazisë por rikrijon kushtet për konfliktet politike rreth vlerave të papajteshme e njëherit i acaroon, e nuk i zbutë, tensionet midis grupeve kulturore.

Versione më të ashpra të kritikës së multikulturalizmit i gjejmë në Francë. Fjala vjen ne tekstet e Pierre André Taguieff. Sipas tij, multikulturalizmi politik apo institucional përbën një model të shoqërisë me shumë bashkësi (shoqëri multikomunotare), i cili i kundërvihet thelbësisht modelit republikan të kombit, apo, më saktësisht, modelit të kombit qytetar. Aty bashkësia politike si e tillë nuk ka më unitet, zhduket në dobi të shumësisë së mikro-bashkësive etnike që synojnë teritorializmin e popullësive të tyre gjegjëse, duke filluar nga lagjja e deri te regjioni.

Multikulturalizmi bëhet i rrezikshëm, sipas Taguieff, për pluralizmin demokratik dhe paqën civile atëherë kur shoqërohet me programe të “diskriminimit pozitiv” apo të “aksionit afirmativ”, që pretendojnë të korigjojnë në mënyrë autoritare diskriminimin social real të disa grupeve me kundërdiskriminime legale e voluntariste. Atëherë ai ushqen garat ndër-etnike e ndër-fetare, gara këto që synojnë të zëvendësojnë sistemin meritokratik, i cili nënkupton garancat për barazinë e shansave (gjasëve) midis individëve. Rivaliteti ndër-etnik, në veçanti, mund të radikalizohet, dhe mund të mjaftojë një shkëndij nga një konflikt i përditshëm midis dy vetave për nxitur përplasje që çojnë te lufta qytetare. Multikomunotarizmi, sipas këtij interpretimi, normalizon kësisoj, një gjendje të luftës qytetare të etnicizuar, latente, duke e nxjerr në shesh pafuqinë e shtetit apo dobësimin e funksioneve të tij qeverisëse dhe kështu rrezikon drejtpërsëdrejti parimin e barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit dhe dëmton parimin e drejtësisë.

Ndonëse teoritë multikulturaliste mbështesin më shumë forma të ndryshme të të drejtave e lirive, megjithatë, edhe vërejtjet kritike të kundërshtarëve të tyre nuk mund të shpërfillen, ngase disa praktika multikulturaliste, në disa kontekste, kanë dobësuar lidhjet e përbashkta politike të qytetarëve.

Tani do ta vendosim çështjen e multikulturalizmit brenda kontekstit të Europës Lindore e Jugë Lindore. Disa politologë të Europës Lindore (si, fjala vjen, Stéphanie Pier-ré-Caps), i kanë përkufizuar shtetet e kësaj pjese të Europës si shtete shumëkombëshe (e jo shtete-kombe), të formuara me dy a më shumë kombe që ekzistojnë si bashkësi të ndryshme, çdonjera prej tyre me vetëdijen për specificitetin e vet (gjuha, trashëgimia kulturore, një kujtesë për përvoja të përbashkëta historike). Këtu mund të bëhet analogjia me idenë e shoqërisë kanadeze si « komb multikulturor », apo me idenë e « situajenëtetit multikulturor », ndonëse ka dallime të dukshme historiko-politike e kulturore.

Për shkak të këtij karakteri shumkombësh, këto shtete u detyruan të kërkojnë modele juridiko-politike e kulturore të cilat duhej të ofronin zgjidhje të disa problemeve që dilnin nga tensionet ndëretnike. Ato kishin shumë kufizime e të meta, sidomos pse shpesh kishin rolin për të fshehur trajta të ndryshme të diskriminimit të grupeve etnike (pakicave), por megjithatë ato përbënin një përvojë historike të zbutjes së konflikteve midis bashkësive të ndryshme etnike. Është fjala për përvoja të tjera historiko-politike, mënyra të tjera nga ato të Europës Perëndimore, në të kuptuarit e shtetit, kombit dhe situajenëtetit (qytetarisë), të relacioneve të tyre, e në veçanti të relacioneve midis kombeve e pakicave kombëtare. Dallimet jo vetëm në raport ndaj Europës perëndimore por edhe dallime midis tyre, në periudha të ndryshme të shekullit të fundit. Kështu bie fjala, sa i takon Kosovës, mund të përmendim dallimin midis Jugosllavisë së parë (1918-1941), si model i shtetit unitar e centralist dhe Jugosllavisë së dytë si shtet federal, i cili institucionalizoi pranimin e dallimeve etnike e kulturore të popujëve që e përbënin. Dallimi i statusit të Kosovës dhe shqiptarëve në këto dy Jugosllavi ka qenë i dukshëm, ndonëse shqiptarët ishin object i represionit në të dyjat. Në mitingun populist të vitit 1989, në Fushë-Kosovë u paralajmërua rënimi pikërisht i strukturës federale dhe parimeve kushtetuese të Jugosllavisë së dytë, të cilat orvateshin deridikund të gjejnë një drejtpeshim midis diversiteteve etnike e kulturore me atë të një forme të reduktuar të situajenëtetit. Mu për këtë, ligjërimet politike të zyrtarëve të Beogradit sot, si bje fjala ai i V. Jeremicit në Konferencën e vendeve të painkuadruara në Teheran, përbëjnë një kontradiktë brenda politikës zyrtare serbe. Derisa para përfaqësuesëve të vendeve të painkuduara Jeremiqi orvatet ta paraqesë Sërbinë e sotme si trashëgimtare legjitime e Jugosllavisë së Titos, ky ligjërim është krejt i papranueshëm për shumicën e opinionit në Sërbë, pikërisht pse gjatë viteve të tëra ajo Jugosllavi u paraqit, sa nga autoritetet politike aq edhe nga ato shkencore, si tradhëti e interesave të sërbeve.

Disa aspekte të problemeve karakteristike për multikulturalizmin në botën perëndimore, u riparaqitën në dy deçenitë e fundit brenda dy proceseve karakteristike dhe thelbësisht të ndryshme: paralelisht me procesin e shpërbërjes së tri federatave shumkombëshe komuniste (Bashkimit Sovjetik, Cekoslllovakisë dhe Jugosllavisë) dhe krijimin e shteteteve të reja, u bë i theksuar procesi i integritetit të këtyre shteteve brenda strukturave mbinacionale të BE-së.

Në fund, desha të përkujtoj se Kushtetuta e përkufizon republikën e Kosovës si një shtet demokratik e njëherit si "shoqëri multi-etnike, e përbërë nga shqiptarët dhe bashkësitë tjera etnike". Kushtetuta pranon si gjuhë zyrtare shqipen dhe serbishten. Por, gjuhë të tjera poashtu (turqishtja, boshnjakishte, gjuha rome) pranohen pakështu në nivelin e komunave, të banuara nga këto pakica. Në këtë Kushtetutë hetohet orvatja për të vendosur një drejtpeshim midis afirmimit të parimit të situajenëtetit (citizenship) dhe parimit të multi-etnicitetit. Te ne ka patur polemika e de-

bate, mjaft interesante lidhur me përpjestimet që kanë këto parime në Kushtetutë, lidhur me rrethanat politike të sajimit dhe adoptimit të saj, në veçanti të legjitimitetit të Pakosë së Ahtisarit, si bazë apo kornizë e kësaj kushtetute. Shumë aspekte të këtyre çështjeve janë diskutuar dhe vazhdojnë të diskutohen. Këtu, desha vetëm të theksoj se këto debate prekin njerën nga çështjet e rëndësishme: raportin midis situajenëtit (qytetarisë, në kuptimin politik) dhe multietnicitetit, raportin midis shumicës e pakicës, midis kombit e shtetit etj. Një aspekt karakteristik i këtyre debateve e polemikave shfaqet ndonjëherë me afirmimin e një konceptioni të shtetit-komb, i cili vë theksin te barazia e të gjithë qytetarëve para ligjit, duke përjashtuar dallimet midis përkatësive etnike, përkatësisht të drejtat e tyre të veçanta. Ndonjëherë mbështetet një konception i kombit si bllok monoetnik brenda të cilit nuk ka vend për diversitetet etnike ; konception ky t i modelit etnik të kombit, i cili synon të dalë identik me shtetin, dhe i cili herë përjashton ekzistimin e etnive të tjera, herë i redukton të drejtat e tyre. Ky konception politik është paraqitur në të gjitha shtetet e reja që dolën nga Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavia. Kësisoj, sllovenët, kroatët dhe shqiptarët, në ish-Jugosllavi, në vitet 60 e kanë kritikuar centralizmin politik dhe univerzalizmin e ngurt të jugosllavizmit (ndonjëherë i cilësuar si sërbi-zëm i zgjeruar) dhe kanë kërkuar afirmimin e veçantive kulturore e politike. Kushtetuta e vitit 1974, me disa ndryshime juridiko-politike që i solli, mund të shikohet deridikund si rezultat i këtyre kërkesave e luftërave politike. Mirëpo, pas krijimit të shteteve të reja që dolën nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, u bë e dukshme edhe një tendencë politike që të afirmohet një model i ngurt i shtetit-komb që u lente pak vend afirmimit të politikave të diversiteteve kulturore dhe mbështetjes së tyre politike. Kësisoj, J. Rupnik, e interpretonte këtë qëndrim me formulën: « më mire të jesh ti pakicë në shtetin tim, se sa unë të jem pakicë në shtetin tend ».

Megjithkëtë, vlen të ceket se vërejtja se Plani i Ahtisarit i sforcoi dimensionet e aspektit multietnik në dëm të dimensionit të situajenëtit, nuk është e pambështetur. Pikërisht për këtë, sfida për institucionet e Kosovës dhe klasën politike ka të bëjë me gjetjen (në praktikën politike) e drejtpeshimeve të domosdoshme të cilat duhet sigurojnë unitetin e shoqërisë, krahas respektimit të specificiteteve kulturore të bashkësive etnike. Kjo është çështje e cila ka të bëjë pikërisht me aspektin thelbësor të debatit në vendet anglo-saksone midis komunitaristëve e liberalëve, midis formave të barazisë qoftë brenda modelit republikan e qytetar qoftë brenda një shoqërie e cila pranon me kushtetutë karakterin multietnik të shoqërisë dhe rrjedhojat që mund të dalin në jetën politike. Plani Ahtisarit kishte paraparë, në sajë të decentralizmit, forma të vetqeversijes së bashkësisë serbe në komunat ku jetojnë, në disa fusha: në fushën e arsimit, në sistemin gjyqësor, në polici, në shëndetësi, kulturë. Rreziku që mund të dalë nga krijimi i zonave të ndara, të izoluar nga tërësia e shoqërisë, me sisteme të mëvetësishme, nuk është i vogël. Si të mbahet kohezioni i shoqërisë, krahas respektimit të kërkesave legjitime të bashkësive etnike? Si të mbahet drejtpeshimi midis dimensionit të situajenëtit, interesave të përbashkëta të shoqërisë dhe të drejtave legjitime kulturore e politike të bashkësive etnike? Midis shumicës dhe pakicave? Këto pyetje mbesi si sfida të klasës politike dhe shoqërisë kosovare. (Europa e bashkuar, si projekt politik, e jo vetëm si hapësirë gjeografike dhe model i qytetërimit, sfidon historinë e shteteve-kombe, traditat e tyre politike, praktikën e tyre qeverisëse, dhe hapë debate rreth raporteve midis natyrës së institucioneve politike të saj (supra-nacionale) dhe diversitetit të kulturave të vendeve që e përbëjnë, duke e marrë në konsiderim edhe multikulturalizmin si një përgjigje të mundshme.)

(Këtu qëndron një sfidë: në ç'mënyrë, duke e bërë të mundur manifestimin e lirë e të gjuhëve, dokeve, traditave kulturore, të mos kultivohet ndarjet, përçarjet, mosbesimet e urrejtjet por toleranca e bashkëjetesa, kohezioni i një shoqërie dhe funksionimi koherent i një shteti demokratik ; ndarjet në shkolla) Amarty Sen: duke u fokusuar te komunitetet, nuk I janë bërë shërbime lirive multikulturore. Përkundrazi.)

FERID AGANI

Universiteti i Prishtinës

Republika e Kosovës nuk është njohur në mënyrë zyrtare si shtet i pavarur dhe sovran nga shumica e shteteve, anëtare të Konferencës së Organizatës Islamike. Kjo befasi e pakëndshme e la shtetin tonë pa përkrahjen e natyrshme, të pritur në periudhën kritike të anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, ende ekzistojnë shpresat, që hutia fillestare e shkaktuar nga shumë faktorë në të dyja anët, do të tejkalohet shpejtë, duke përforcuar miqësitë shumë shekullore me shumicën e këtyre shteteve, në veçanti me shtetet e botës Arabe. Në prezntimin tim do të fokusohem në korelacionin e faktorëve që përfshijnë identitetin fetar të Shqiptarëve të Kosovës, laicitetin ose sekularizmin konstitucional të Republikës së Kosovës (varësisht se në cilën gjuhë lexohet Kushtetuta); si dhe refleksionet e tyre në politikën e jashtme të shtetit tonë demokratik.

I

Fillimisht, pse të theksohet aq shumë identiteti fetar i qytetarëve në situatën kur vendi është duke u përballur me vështirësi serioze ekonomike, politike dhe sociale? Identiteti i formësuar fetar i shumicës së qytetarëve të Kosovës, i mishëruar brenda identitetit kombëtar Shqiptar paraqet gurë të rëndësishëm themeltar për stabilitetin e përgjithshëm psikosocial dhe prosperitetin e vendit, si në nivelin individual ashtu edhe në atë kolektiv. Në librin e tij *Varietetet e Përvojës Fetare*, William James, profesori i parë i psikologjisë në Amerikë pohon: vetëdija fetare i jep besimtarit "hapësirë të re të fuqisë" që siguron stabilitet, kontinuitet, ngushëllim, dhe fuqi për t'u përballuar me sfidat dhe pasiguritë e jetës – sëmundjen, vdekjen, fatkeqësin, tragjedin personale. Për besimtarin, vetëdija fetare paraqet qendrën e energjisë dinamike, "vendin e zjarrit në vetëdijen e njerit, grupin e ideve të cilave ai u përkushtohet, dhe në bazë të cilave ai punon, quani *qendra e natyrshme e energjisë së tij personale*" (James 1902/1963, p. 200).

Shumë studime kanë zbuluar se identiteti i formësuar fetar ka ndikim qenësor në kuptimin dhe qëllimin e jetës, zvogëlimin e ankthit, vet-konceptimin pozitiv, mungesën e shqetësimit dhe brengosjes, kënaqësin me punë dhe martesë, kënaqësin e përgjithshme, plotësin e jetës, mirëqenien mendore dhe aftësit personale.¹ Në këtë drejtim, Markstrom (1999) demonstroi se ego fuqit e shpresës, dëshirës, qëllimit, besnikëris, dashuris, kujdesit, dhe vetëbesimit shkollor tek adoleshentët, ishin të shoqëruara me forma të ndryshme të përkushtimit fetar². Rezultatet e këtij studimi kanë rëndësi të veçantë për vendin tonë duke e pasur parasysh faktin se kemi popullatën më të re në Europë, me më shumë se gjysmën e popullatës nën moshën 20 vjeçare³.

1 Petersen L.R. Roy A. Religiosity, Anxiety, and Meaning and Purpose: Religion's Consequences for Psychological Well-Being. *Review of Religious Research*, Vol. 27, No. 1 (Sep., 1985), pp. 49-62

2 Markstrom C.A. Religious involvement and adolescent psychosocial development. [Journal of Adolescence](#), Volume 22, Issue 2, April 1999, Pages 205-221

3 FAO Report. Code: gcp/kos/003/nor. Title: Pilot project on resettlement of minorities and confidence building between minorities and Albanian communities in Kosova. 2007.

Duke e thënë këtë, unë në asnjë mënyrë nuk anashkalojë qëndrimet e individëve të cilët fenë ose besimin në Zot nuk e shohin si burim të fuqisë. Megjithatë, pjesa më e madhe e popullatës së Kosovës ka identitet të formësuar fetar; në numra të përafërt, 90% Musliman, 6% të Krishterë Orthodox dhe 4% të Krishterë Katolik⁴.

II

Pranimi dhe manifestimi i këtij identiteti fetar është i garantuar për çdo qytetarë të Kosovës me Nenin 38 të Kushtetutës. Paragrafi 2 i këtij Neni thotë: "Liria e besimit, e ndërgjegjes, dhe e fesë, ngërthen të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar". Paragrafi 3 i këtij Neni garanton që: "askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej, që në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, të marr pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj; ndërsa paragrafi 4 i të njëjtit Neni thekson se: "Liria e manifestimit të fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik, të shëndetit ose të drejtave të personave të tjerë".

Në mesin e partive politike në Kosovë është gjërë i përkrahur postulati se sekularizmi paraqet fundament të modernitetit politik. Megjithatë, në Kushtetutë ekziston një paqartësi serioze përkitazi me këtë nocion. Neni 8 i Kushtetutës në verzionin Anglisht dhe Serbisht e përcakton Republikën e Kosovës si shtet "sekular", "që është neutral në çështjet e besimeve fetare"; ndërsa në verzionin Shqip si shtet "laik"! A është e rastit kjo diskrepancë e fjalëve?

Përdorimi i njëkohshëm i nocionit "laik" në verzionin Shqip të Kushtetutës dhe nocionit "sekular" në verzionin anglisht dhe serbisht, mund të kuptohet si çështje e thjeshtë e përkthimit, që sygjeron kuptim plotësisht të ngjashëm juridik, por mund të jetë edhe reflektim i konfuzionit gjenuin politik përkitazi me bazat e rregullimit juridik të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe atyre fetare, si dhe çështjeve publike dhe fetare në Republikën e Kosovës. Ky konfuzion mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë negativ në zbatimin e të drejtave kushtetuese të qytetarëve të Kosovës për lirin e besimit, ndërgjegjes dhe fesë, si psh., ndalesa e para ca kohshme e shkollimit për vajza me mbulesë dhe ndalesa e të drejtës së punës për mësueset femra që mbajnë mbulesë.

Çfarë janë politikat e laicizmit dhe sekularizmit sipas përkufizimit të tyre? Origjina e nocionit "laik" në gjuhën latine dhe "laikos" në gjuhën greke nënkupton përkatësinë grupit të njerëzve dhe masave, dhe jo klasës së caktuar, të priftërinjve dhe zyrtarëve të tjerë fetar⁵. Pas revolucionit Françez ky kuptim ndryshoi në mbajtjen e fesë larg pushtetit ekzekutiv, gjyqësor, dhe legjislativ të qeverisjes. Kjo përfshin ndalesën e fesë shtetërore, si dhe mbështetjes qeveritare të cilësdo pozite fetare, qoftë ajo fetare ose ateiste. Ngjashëm me fjalën 'laik', që në Francë është përdorë nga Katolikët, nocioni 'sekular' është përdorë gjërë në Angli nga Protestantët.

Dallimet ndërmjet dy nocioneve nuk janë thjeshtë gjuhësore. Metin Camcigil, Kryetar i Shoqatës Amerikane të Ataturkut thotë se "ekziston injorancë e përhapur përkitazi me dallimin ndërmjet laicizmit dhe sekularizmit si dhe historive të tyre. Laicizmi nënkupton përjashtimin e autoritetit fetar mbi atë publik, ndërsa sekularizmi

4 Mons. Mark SopI, Hearing: "Kosova: Current and Future Status". Congress of the United States – Committee on International Relations. May 18 2005.

5 Abbas Jirari, Islam and Laicism. Rabat. 2003

paraqet kontratën e ndarjes së autoritetit mbi sferën publike ndërmjet dy palëve të barabarta, institucionit fetar dhe shtetit (që nga disa filozofë të politikës quhet kompromisi Viktorian). I pari mund të quhet sistem unitar, ndërsa i dyti sistem dualist; në laicizëm ekziston muri ndërmjet Autoriteteve Civile dhe Autoriteteve Fetare, ndërsa në sekularizëm ekuilibri ndërmjet tyre⁶. Shembuj tipik të shteteve laike janë Franca dhe Turqia, ndërsa të shteteve sekulare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shumica e madhe e shteteve të Bashkësisë Europiane⁷.

Koncepti Françez i laicizmit përfshin mungesën e fesë shtetërore dhe ndarjen pa-suese të institucioneve fetare nga shteti duke e siguruar pamundësin e ndërhyrjes së institucioneve fetare në çështje qeveritare si dhe të Qeverisë në çështje fetare. Megjithatë, promovimi i koncepteve si liria e të menduarit e ka shtrembëruar konceptin e laicizmit deri në përjashtimin absolut të çdo përmbajtje fetare nga jeta publike, deri në model të maskuar të antiklerikalizmit dhe pengimit të të drejtës individuale për shprehjen fetare, që në vend të promovimit të lirisë së të menduarit, pengon besimtarin që të zbatoj fenë e tij ose të saj. Në këtë mënyrë laicizmi e shndërron veten në ideologji dogmatike që përcakton se çka duhet të mendohet dhe thuhet, duke e kërcënuar lirinë fetare⁸.

Në mënyrë implicite, në shtetet laike si Franca dhe Turqia, debati për çështje fetare, përgjithësisht konsiderohet si i papajtueshëm me debatin racional politik. Liderët politik mund të praktikojnë hapur fetë e tyre, mirëpo prej tyre pritet që të përmbahen nga përzierja e jetës private fetare me funksionet e tyre publike.

Presidenti Sarkozy ka kritikuar së voni këtë çasje si "laicitet negativ" dhe synon që të zhvillojë "laicitetin pozitiv" që njeh kontributin e fesë në kulturën Françeze, historin dhe shoqërin e saj, që lejon besimin në diskursat publike, si dhe subvencionet qeveritare për grupet fetare.⁹ Sarkozy i sheh fetë kryesore në Francë si kontribuese pozitive për shoqërinë Françeze. Populli Françez e zgjodhi atë për President mbi platformën e propozimit për modernizimin e parimit një shekull të vjetër Republikan të laicitetit¹⁰. Në Dhjetor 2007 derisa e theksonte rëndësin e lirisë së mendimit¹¹, ai deklaroi se besimi duhet të kthehet në skenën publike.

Përkitazi me këtë çështje Papa Xhon Pali II ka deklaruar: "sekularizmi mirë i kuptuar nuk duhet të ngatërrohet me laicizmin". Derisa sekularizmi paraqet "respektin pr të gjitha besimet nga ana e shtetit, që siguron ushtrimin e lirë të riteve fetare, si dhe aktivitetëve shpirtërore, kulturore dhe bamirëse të komuniteteve të besimtarëve"; Ndërsa, laicizmi, sqaroi ai nënkupton tentimin e shtetit për të anashkaluar këtë dimension, në nivelin individual ose të bashkësisë.¹²

6 Metin Camcigil. The Concepts of the Turkish Model and the Greater Middle East Initiative. President of Atatürk Society of America

7 M. Orhan Tarhan. "The Holy Cow Democracy" letter No.106. 2007.

8 ZE04112521 - 2004-11-25. Permalink: <http://www.zenit.org/article-11630?l=english>

9 Beita, Peter B. [French President's religious mixing rules critics](#) Christianity Today, Jan. 23, 2008

10 <http://www.lexpress.fr/info/france/dossier/sarkozy/dossier.asp?id=430149> Religions, République, intégration, Sarkozy s'explique

11 [Sarkozy breaks French taboo on church and politics](#), Christianity Today, Dec. 23, 2007.

12 Jan. 12 2004 address to the diplomatic corps accredited to the Holy See

Koncepti modern ligjor i lirisë fetare si unitet i *lirisë së besimit* dhe *lirisë së adhurimit* pa fe zyrtare të mbështetur nga ana e shtetit ka lindur në SHBA. Në veprën e tij [Demokracia në Amerikë](#)¹³, [Alexis de Tocqueville](#) vëren sinergjin ndërmjet fesë dhe demokracisë në Shtetet e Bashkuara, dhe qorton për atë që ai e quan teprim të laicitetit dhe antiklerikalizmit në mesin e demokratëve Francez.

Amandamenti i Parë në Kushtetutën e SHBA përfshin dispozitat që ndalojnë ndërhyrjen e qeverisë në "ushtrimin e lirë" të fesë, por edhe "themelimin" e fesë nga ana e qeverisë. Konsiderohet se këto dy dispozita së bashku përmbushin ndarjen e institucioneve fetare nga shteti. Megjithatë, kjo ndarje nuk nënkupton pengimin e sjelljes fetare në vende publike nga ana e nëpunësve civil. Nëpunësit civil, përfshirë edhe Kryetarin e SHBA, shpesh bëjnë deklaratat dhe njoftime me përmbajtje fetare. Për dallim nga Franca, në SHBA nga aspekti ligjor nuk është kontraverze çështja e veshjes me shenja dalluese fetare në shkollat publike. Për më shumë, qeveria e SHBA i liron institucionet fetare nga pagesa e tatimeve si organizata joprofit në rast se ato nuk janë hapurazi të ndërlidhura me politikë. Madje, ushtria përfshin klerikët e paguar nga qeveria me qëllim të përmbushjes së nevojave shpirtërore të ushtarëve.

Mbështetur në këto fakte, autoritetet ekzekutive, gjyqësore dhe legjislativ të Kosovës duhet që sa më shpejtë të tejkalojnë dikotomin ekzistuese kushtetuese duke e përcaktuar Republikën e Kosovës si shtet sekular edhe në verzionin Shqip të Kushtetutës, me të gjitha implikimet e saja politike. Ato, poashtu duhet që, duke e pasur parasysh edhe traditën e deritanishme kushtetuese, nëpërmjet ligjeve përkatëse të njohin fetë zyrtare (si në Belgjikë) ose organizatat fetare (si në Francë). Në Kushtetutat e mëhershme të Kosovës (Ligji kushtetues 1969 dhe Kushtetuta e 1974), Bashkësia Islame e Kosovës, Ipeshkvia Katolike e Kosovës dhe Kisha Ortodokse Serbe kishin status juridik kushtetues si bashkësi tradicionale fetare. Aktualisht, kjo e drejtë i njihet vetëm Kishës Ortodokse Serbe duke anashkaluar pa asnjë arsye Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Ipeshkvinë Katolike të Kosovës. Ndonëse laike ose sekulare pesë nga 27 shtetet e Bashkësisë Europiane kanë fe zyrtare shtetërore: Qipro (Kishën Ortodokse Qipriote), Danimarka (Kishën Kombëtare të Danimarkës), Greqia (Kishën e Greqisë), Malta (Kishën Romane Katolike), dhe Anglia në Britanin e Madhe (Kisha e Anglisë). Ndërsa disa kisha të tjera kanë marrëdhënie më të afërta me shtetin.¹⁴ Pra siç po shihet, zgjidhjet konkrete janë në pajtim me veçantit e çdo shteti.

Legjislacioni që do të miratohet përkitazi me këto çështje duhet të mbështetet në dy parime themelore demokratike: konceptin e shtetit sekular me shoqëri të hapur dhe të lirë, që nuk është fare i kontestueshëm; dhe konceptin e respektimit të vullnetit të shumicës dhe traditës së saj, në pajtim me standardet më të larta të drejtave të njeriut për të cilin ende ekzistojnë dilema.

Modeli Belgjian i të kuptuarit të sekularizmit është më i përshtatshmi për rrethanat e Kosovës. Me këtë model, në bazë të Kushtetutës së Belgjikës, nga fondet e qeverisë paguhen zyrtarët e feve kryesore që janë të "njohura" nga shteti (Katolicizmi, Protestantizmi, Anglikanizmi, Ortodoksizmi, Judaizmi, dhe Islami), por edhe personat që kryejnë funksione të ngjashme për komunitetin laik. Njëkohësisht, shkollat

¹³ [Democracy in America](#), Vintage Books, 1945, p. 31-32

¹⁴ Ferrari, Silvio. "[Silvio Ferrari on "Church and State in Europe"](#)". Concordat Watch. Retrieved on [2007-08-23](#).

publike në Belgjik duhet t'u ofrojnë të gjithë nxënësve zgjedhjen ndërmjet studimit të njërit prej religjioneve të "njohura" që u përmendën më sipër, dhe kursit mbi moralin jo-fetar. Konsideroj se zgjidhje të ngjashme duhet të zbatohen edhe në Republikën e Kosovës.

III

Si e këtillë Republika e Kosovës do të paraqes arenë unike të multikulturalizmit në të cilën vlerat Islame të mishëruara në korpusin e identitetit kombëtar Shqiptar dhe të komuniteteve të tjera etnike, do të paraqesin garant të tolerancës dhe të bashkëpunimit ndërfetar, si dhe promotor të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjërë.

Zoti i madhërishtëm në Kuranin famëlartë i drejtohet të dërguarit të tij Muhamedit, paqë dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, me fjalët: Thuaj: "Ne i kemi besuar Allahut, edhe asaj që na u zbrit neve, edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Ishakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që u është zbritur pejgamberëve..."¹⁵

Kreativiteti gjenuin racional i llojit njerëzor paraqet komponentën më të vlefshme të ekzistencës njerëzore; megjithatë shtytja e natyrshme e qenies njerëzore për koherencë metafizike me mikro dhe makrokosmosin rrethues, paraqet domosdoshmëri duke i pasur parasysh kufizimet e tij perceptuale. Mënyrat e arritjes së kësaj koherence janë të ndryshme dhe të shumta, ashtu siç janë edhe rrugët e mendimit njerëzor. Ato mund të shkojnë nëpër dyert e përvojës së strukturuar fetare, nëpër përjetime të pastrukturuara shpirtërore, ose edhe si mohim i pjesërishtëm ose i plotë i të dyjave, në trajektoret materiale mentale, agnostike ose ateiste. Çdo individ ka të drejtë që të kërkojë dhe të arrijë këtë koherencë ose që ta mohoj domosdoshmërin e saj. Institucionet shtetërore duhet të mbështesin qytetarët në këto përpjekje me qëllim të themelimit të personaliteteve të shëndosha dhe kreative si dhe të shoqërisë moderne dhe përparimtare të mbështetur në vlera të mirëfillta individuale dhe kolektive, që nuk përjashtohen ndërmjet veti.

Shteti demokratik, sekular dhe modern European i Kosovës paraqet urë të natyrshme të bashkëpunimit me shtetet e botës Arabe, të cilat në institucionet dhe popullin e Kosovës gjithmonë do të gjejnë partner të besueshëm dhe mik të sinqert.

15 Kur'an, Ali Imran (III), 84

BEKIM SEJDIU

Këshilltar i Lartë i Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës

Te ndëruar të pranishëm,

Është kënaqësi e vecantë për mua të marrë pjesë në këtë konferencë me një tematikë kaq interesante dhe të rëndësishme për ne. Më lejoni paraprakisht të falënderoj organizatorët e kësaj konference për ftesën. Gjithashtu, iu uroj mirëseradhje mysafirëve të ndëruar nga vendet Arabe. Mendoj se kjo konferencë është një mundësi e mirë për të parë perspektiva të ndryshme për marrëdhëniet e Kosovës me botën arabe.

Perspektiva që une paraqes sa i përket raporteve të Kosovës me botën arabe është e natyrës politike. Mendoj se kjo është në përputhje me cilësinë në të cilën jam ftuar të marrë pjesë këtu, përkatësisht atë të këshilltarit politik të Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.

Zonja dhe zotërinjë,

Është e kuptueshme se kur ne këtu në Kosovës flasim për marrëdhëniet politike me botën arabe, në këtë periudhë kohore, në radhë të parë mendojmë në njohjen, përkatësisht mosnjohjen, e shtetit të Kosovës nga vendet arabe. Kjo është e kuptueshme kur kihet parasysh fakti se me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, me 17 shkurt të këtij viti, Kosova ka hyrë në një fazë qenësore për fatin e saj, përkatësisht atë të jetësimit të shtetësisë së vet. Njohja ndërkombëtare e shtetit të Kosovës nga sa më shumë shtete, është parakusht për jetësimin e shtetit të Kosovës në praktikë. Njohja sa më e shpejtë e shtetit të Kosovës do ishte shtytje e madhe për stabilitet politik dhe për forcimin e rendit dhe ligjit, sidomos në Veri të Kosovës, ku rendi kushtetutes i Republikës së Kosovës sfidohet haptazi nga struktura ilegale serbe. Poashtu, njohja sa më e shpejtë do përshpejtojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe do ishte një shtytje e madhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Duke u nisur nga ky fakt, dhe nga mandate i saj ligjor, Ministria e Punëve të Jashtme pothuajse tërë potencialin e saj gjatë tre muajve të ekzistimit të saj e ka vënë në dispozicion të njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës.

Zonja dhe zotërinjë të nderuar,

Kohët e fundit, ne si Ministri e Jashtme e Republikës së Kosovës shumë shpesh jemi kritikuar nga brenda për mosnjohjen e deritashme të shtetit të Kosovës nga asnjë vend arab. Natyrisht, në shumicën e rasteve këto kritika janë të kuptueshme dhe qëllimira. Megjithatë, ato burojnë nga të paktën 5 përceptime të gabuara mbi të cilat bazohen qëndrimet tona, flas për qëndrimet e klases politike dhe shoqërisë kosovare në tërësi, ndaj botës arabe. Unë do i elaboroj shkurtimisht këto përceptime dhe shpresoj se gjatë debatit do mund t'i komentojmë më tepër.

Përceptimi i parë i gabuar në Kosovë është se në vendet myslimane feja Islame është faktori kryesor, apo i vetëm, që ndikon në formulimin e politikave të jashtme. Duke u nisur nga kjo, në Kosovës është menduar se, duke qenë se Kosova ka një shumicë myslimane, këto vende do e njohin menjëherë dhe pa hezimit pavarësinë e Kosovës.

Faktorët që ndikojnë në formulimin e politikave të jashtme të vendeve të ndryshme janë të shumë dhe të ndërlikuar. Identiteti, përfshirë edhe atë fetar, është një faktor konstant gjeopolitik, por jo i vetmi dhe jo domosdo më i rëndësishmi. Cdo shtet formulon politikën e tij ndaj një cështjeje të caktuar ndërkombëtare, duke u nisur nga mënyra se si i projekton interesat e veta në raport me cështjen në fjalë. Tani, se çfarë roli luan identiteti në këtë drejtim, dhe cili është roli i fesë në ndërtimin e identitetit, kjo është një tematikë tjetër. Bile kjo është njëra ndër cështjet me të debatuar në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Përceptimi i dytë i gabuar në Kosovë është se ekziston një qëndrim i vetëm i vendeve arabe ndaj pavarësisë së Kosovës. Në fakt, kur flasim për njohjen e shtetit të Kosovës nga vendet arabe, ne në Kosovës shumëherë shpërfillim faktin se ka disa shtete arabe. Liga Arabe i ka 22 shtete anëtare. Kur bëhet fjalë për njohjen e shtetit të Kosovës, ndonëse ka prirje nga shumë nga këto vende për të arritur një qëndrim kolektiv, në fund të fundit cdo shtet kalkulon interesat e veta në radhë të parë. Poashtu, qëndrimi i cdo shteti ndikohet nga faktor dhe dinamika të drendshme. Kështuqë nuk besoj se është e mundur të flitet për një qëndrim të vetëm arab ndaj Kosovës. Flas gjithmonë për qëndrime zyrtar. Sikur që është vështirë të flitet për një qëndrim Evropian, apo Latino-Amerikan ndaj një cështjeje të caktuar të politikës ndërkombëtare.

Përceptimi i tretë i gabuar ka të bëjë me përshtypjen e gabuar se vendet arabe, dhe ato të myslimane përgjithësisht, nuk po e njohin Kosovën për shkak se Kosova është çliruar dhe është krijuar si shtet në një process ku shtete të fuqishme të përendimit, në radhë të parë SHBA-të kanë luajtur një rol qenësor. Ky përceptim është rrjedhojë logjike e një rivaliteti imagjinar në mes të Lindjes myslimane dhe Perëndimit të krishterë.

Nuk besoj se është e mundur të flitet për një ndarje të tillë politike në mes të botës Perëndimore dhe asaj Lindore. Aq me pak të flitet për një rivalitet apo konflikt, i cili domosdo do shfaqej në përmasa mitike dhe rrjedhisht irracionale. Kur jemi tek marrëdhëniet e shteteve arabe me ato perëndimore, sidomos me ato të BE-së dhe NATO-s, atëherë ato shumë më tepër karakterizohen nga një nivel i lartë bshkëpunimit, në fushën e sigurisë, sidomos luftës kundër terrorizmit, bashkëpunimit ekonomik e kështu me radhë.

Pra, orientimi i natyrshe i Kosovës drejtë integrimeve Evro-Atlantike nuk është faktor që e pengon njohjen e saj nga bota arabe. Bile një Kosovë e anëtarësuar në BE dhe NATO do i kontribuonte edhe më shumë forcimit të lidhjeve në mes të vendeve arabe me këto dy organizma të rëndësishëm global.

Përceptimi i katërt i gabuar është se Kosova është prioritet kryesor i politikës së jashtme të cdo vendi, përfshirë edhe ato arabe. Ndonëse Kosova ka qenë njëra ndër cështjet me të rëndësishme në axhendën e politikës ndërkombëtare gjatë këtij viti, është gabim të mendohet se Kosova është gjithnjë në krye të axhendës, dhe se ajo

ka rëndësi të njëjtë për cdo vend dhe rajon. Unë mendoj se axhenda e politikës së jashtme të vendeve arabe dominohet më shumë nga probleme si kriza bërthamore Iraniane, Iraku, problemi Palestinez apo tendecat destabilizuese në Liban. Është krejt e natyshme se këto çështje preokupojnë shumë më tepër sesa Kosova vendet arabe, për shkak të ato prekën drejtpërdrejtë nga këto probleme. Ndërkohë që zhvillimet në Kosovë nuk prekin drejtpërdrejtë botën arabe. Të paktën jo në përmasat e njëjta me çështjet e lartëpërmendura.

Përceptimi i fundit në Kosovë është se vendet arabe dhe ato myslimane përgjithësisht, nuk e kanë njohur Kosovën ekskluzivisht për shkak të mungesë së interesit të institucioneve të Kosovës për kontakte me këto vende. Pa dashur të minimizoj rëndësinë e kontakteve të drejtpërdrejta të nivelit zyrtar, unë mendoj se është i paqëndrueshëm pretendimi se po të kishte kontakte më të shpeshta do kishim njohje të menjëhershme të Kosovës nga këto vende. Faktorët që ndikojnë në qëndrimin e vendeve të ndryshme ndaj njohjes së shtetit të Kosovës janë të ndryshëm. Një numri vendesh, ku bëjnë pjesë edhe shumë vende arabe, ju nevojitet më shumë kohë për të vënë Kosovën në rëndësi dhe për të marrë vendim. Ne duhet të tregojmë mirëkuptim për këtë.

Ndërsa sa i përket kritikave të shumta se institucionet e Kosovës nuk kanë qenë sa duhet aktive me vende arabe, unë dëshiroj që për fund të ritheksoj atë që tha Ministri i Jashtëm në fjalimin e tij sot, se ne si Ministri që nga themelimi i kemi konsideruar me prioritet kontaktet me vende dhe personalitet të ndryshme nga bota arabe. Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm për peshën që kanë këto vende në arenën globale dhe për interesin e Kosovës për marrëdhënie ekonomike dhe politike me këto vende. Poashtu, jemi mirënjohës për kontributin e shumë vendeve arabe në rimëkëmbjen ekonomike dhe stabilitetin politik të Kosovës pas luftës. Ministria e Punëve të Jashtme ka kontakte të vazhdueshme me zyrtar të vendeve të ndryshme arabe. Në shumicën absolute të takimeve kemi hasur në mirëkuptim të zyrtarëve të vendeve arabe ndaj kërkesave dhe aspiratave tona. Tani, parashikimet në politikën e jashtme është vështirë të bëhen me saktësi të madhe. Mirëpo unë besoj fuqimisht se Kosova do njihet nga një numër vendesh arabe në një afat jo të largët. Një hap i tillë në radhë të parë do ishte një mbështetje për aspiratat legjitime të popullit të Kosovës për të jetuar i lirë. Kjo do i kontribuonte paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe në rajon. Kjo gjithashtu do hapte perspektiva të reja për marrëdhëniet e Kosovës dhe të rajonit përgjithësisht me botën arabe.

Ju falënderit.

JAMAL BAROUT

Forumi Syria 2025, Siri

Më lejoni që, duke dhënë disa vërejtje të mia dhe duke u lidhur disa herë me para-folësit, të prek këto çështje: 1. Shteti qytetar, 2. Islami evropian, 3. Shteti laik, 4. Njohja e shtetit të Kosovës nga shtetet arabe

1. E quaj për fat të mirë që një organizatë joqeveritare si "Forumi 2015", duke përvetësuar idenë e shtetit për të gjithë qytetarët në vend të idesë së shtetit kom-bëtar, ka ndërtuar mençurisht asi vizioni për të ardhmen që përkon me vizionin për të ardhmen që e ngërthen në vete Kushtetuta e Kosovës. Përvetësimi i këtillë i ideve në pajtim me kushtetutën nga nismat qytetare s'do mend se i shërbejnë njëmendësimit të një shteti të ri.

Ideja e shtetit për të gjithë qytetarët na paraqitet edhe ne arabëve me interes të jashtëzakonshëm. Arabët që jetojnë brenda shtetit të Izraelit, po t'i përkthejmë në gjuhën kushtetuese përpjekjet e tyre që bëjnë përmes shoqërisë civile dhe partive që kanë, i bie se përpiqen që ta bëjnë Izraelin shtet për të gjithë qytetarët. Izraeli siç dihet sot për sot definohet si shtet i hebrenjve.

Përvoja e Kosovës vërtet bie ide të reja si mund të zgjidhet problemi më i mprehtë në Lindjen e Mesme e që është konflikti arabo-izraelit. Ky kalim i mundshëm nga shtet për hebrenj në shtet për të gjithë qytetarët kurrësi nuk do të thotë se do të bëhej mbi idenë e mosdurimit që kanë arabët ndaj hebrenjve. Po të gjurmojmë mirë historinë do të vërejmë se hebrenjtë i janë kthyer Kudsit dy herë, një herë falë ndihmesës së prijësit të myslimanëve Omer Hatabi dhe herën tjetër falë ndihmesës së Salahuddin Ejubit, ndërkaq që është e vërtetë që ka pasur edhe dëbim të tyre si në Andalizi. Të përmend me këtë rast edhe mikpritjen dhe solidarizimin që u kanë bërë atyre shqiptarët.

Veçse për problemin më të mprehtë të Lindjes së Mesme që është konflikti arabo-izraelit, ideja e shtetit qytetar do të na shërbente ne arabëve edhe për transformimet demokratike që po ngjajnë te ne me të madhe në procesin e reformimit të strukturave qeverisëse.

Shtetet arabe, siç përmendi dr. Ridvan Al-Sayed, kanë probleme të ndjeshme në procesin e ndërtimit demokratik të sistemit qeverisës, ato ende s'kanë gjetur në vend të kombit ndonjë element gjithëpërfshirës me të cilin do të definoheshin. Ndër të parat gjëra nga të cilat mund të përfitojnë shtetet arabe në këto transformime demokratike nga përvoja e Kosovës si shtet qytetar, janë trajtimi i multikulturalizmit dhe marrëdhëniet fe-shtet.

2. Sa i përket islamit evropian, më duhet të shënoj vërejtjen se ky term nuk ka të bëjë me ndonjë dogmë të re besimi siç mund të keqkuptohet, porse ka të bëjë me kuptimin antropologjik të kulturës, do të thotë shpreh mënyrën si përjetohet e si përfilllet islami pa u rënë ndesh vlerave dhe shpirtit të modernizmit.

Në mbështetje të këtij kuptimi, pa e interpretuar - le ta kuptojë secili në mënyrën e vet, po sjell shembullin e imamit egjiptian Muhamed Abduhu i cili kur vizitoi Francën

në fund të shekullit 19 tha fjalën e famshme që kishte parë atje islam pa myslimanë kurse në Egjipt po shihe myslimanë pa islam.

3. Lidhur me dallimin që bëri dr. Ferid Agani ndërmjet laicizmit dhe sekularizmit dhe dallimeve të tjera teorike në mënyrë të detajuar, pajtoj plotësisht. Por, nga leximi që i kam bërë Kushtetutës së Kosovës që besoj ta kem lexuar thellësisht, më rezultoi se me përcaktimin e shtetit të Kosovës si laik synohet më shumë sekularizmi sesa laicizmi në kuptim tradicional francez si bindje kundërfetare, sepse në kushtetutë pranohej feja, lejohej kalimi në fe tjetër dhe mbroheshin fetë, elemente këto që biejnë ndesh me atë kuptim tradicional francez të laicizmit i cili më rezultoi të mos jetë synuar.

Bile them që shtetet arabe që në procesin e transformimeve demokratike po e kanë si problem të mprehtë mënyrën si ta trajtojnë fenë, kanë çka përfitojnë nga përvoja kushtetuese kosovare lidhur me ndërtimin e marrëdhënieve fe-shtet. Laicizmi të shqiptarët është i hershëm dhe ka traditë. Dua të përmend këtu përpjekjet e Ahmet Zogut në këtë drejtim për t'i dhënë natyrë laike shtetit. Për këto përpjekje të tij liderë të Rilindjes Arabe kanë shkruar në gjuhën arabe në vitet e njëzeta të shekullit të kaluar. Këtë fakt po e përmend edhe në kontekst të theksimit të raporteve tona historike e kulturore.

4. Shpreh bindjen se shtetet arabe, më saktë, shumica e shteteve arabe nuk kanë absolutisht asnjë arsye të mos e pranojnë shtetin e Kosovës. Njohja e Kosovës as do t'u sillte probleme në marrëdhëniet me Amerikën as me shtetet evropiane dhe për shumicën e tyre as do të shërbente si pretekst për t'u nxitur ndonjë lëvizje e atjeshme separatiste.

Në arabët që po marrim pjesë në këtë konferencë e që disa kemi fuqi në procesin e vendimmarrjes të qeveritë tona e disa në krijimin e opinionit publik kemi detyrat tona për ta nxitur njohjen, por edhe shoqëria kosovare ka detyrën që të gjallërojë marrëdhëniet me shtetet arabe me vetëdijen që shtetet ndërtojnë politikën e tyre para së gjithash sipas interesave që kanë.

Para se ta përmbyll fjalimin e shoh me interes të theksoj faktin që njohja e një shteti nuk do të thotë gjithsesi dhe ndërtim i marrëdhënieve të ngushta me të, ta zëmë një shembull të afërt: Shqipërinë e njohin për shtet gjithë shtetet arabe por sa prej tyre kanë ambasada atje. Shembull tjetër ta zëmë Sirinë e cila megjithëse njeh gati gjithë shtetet e botës, vetëm në 60 ose 70 prej tyre ka ambasada.

Prandaj gjithsesi duhen nxitur investitorët arabë nga Kosova me qëllim që marrëdhëniet të jenë sa më të gjalla dhe me qëllim që njohja e shtetit të Kosovës të përbëjë interes edhe për shtetet arabe si subjekte të njohjes.

Le të shpresojmë se njohja e shteteve arabe është çështje kohe!

HANY SALAH

Agjensioni i lajmeve "IslamOnline", Egjipt

Falënderoj Forumin 2015 për ftesën që të marrë pjesë në këtë konferencë që po mbahet në Kosovë ku më pëlqen shumë të vij. Mbajtja e kësaj konference është hap fillestar që mendoj se është vonuar shumë. Roli i intelektualëve, mendimtarëve dhe gazetarëve duhet të jetë pikë së pari të arrijnë te e vërteta e gjërave dhe pastaj të orientojnë popujt dhe qeveritë çfarë qëndrimi të marrin ndaj gjërave të e vërteta e të cilave kanë arritur më parë. Kjo konferencë sigurisht që na shërben që secila palë prej nesh të arrijmë te e vërteta.

Z. Veton Surroi vlerësoi për Kosovën se ende nuk ka ndonjë strategji të politikës së jashtme. Mendoj që as shtetet arabe nuk kanë ndonjë strategji të politikës së jashtme ndaj Kosovës. Këtu gjen shprehjen roli i ne intelektualëve, mendimtarëve e gazetarëve që të kthehemi dhe t'i orientojmë qeveritë tona.

Kosova nuk duhet të trajtohet thjesht çështje e brendshme e Evropës. Edhe shtetet islame duhet të kenë interesimin për të. Ne, si myslimanë, sigurisht që falënderojmë perëndimorët e krishterë që u ndihmuan myslimanëve të Kosovës dhe unë personalisht mendoj që Kosova mund të dalë projekt ndërkombëtar i paqes ndërmjet civilizimeve dhe kështu të ndryshojë roli i Ballkanit i cili më parë ka qenë baruti i luftërave.

Një ditë para se të vij këtu, jam kujdesur të takohem me zëvendëskryeredaktorin e revistës "Politika e Jashtme" e cila është revistë zyrtare. Nga ai kam kuptuar që qëndrimi i heshtur i Egjiptit është qëndrim i përkohshëm i diktuar nga presionet që i janë ushtruar. Kam marrë vesh që Egjipti ka nisur ta studiojë rishtazi qëndrimin ndaj pavarësisë së Kosovës sidomos pasi ka parë që Serbia i ka kthyer ambasadorët në shtetet evropiane që e kanë njohur Kosovën për shtet e nga të cilat fillimisht i pati larguar.

Ndonëse Kosova ka vetëm dy milionë banorë dhe vetëm 11 mijë metra katrorë mund të luajë rol të madh në përafrimin e civilizimeve ashtu siç po luan Turqia, prandaj për të duhet të ketë interesim e gjithë bota e jo të trajtohet si çështje e brendshme evropiane.

Mendoj që për t'u thelluar marrëdhëniet ndërmjet vendeve arabe dhe Kosovës ka shumë punë që mund të ndërmerren e që janë me interes dypalësh e sidomos për Kosovën. Mund të ftohen, krahas biznismenëve të tjerë, edhe biznesmenë arabë që të dhurojnë për Kosovën, siç i pati ftuar Berisha në vitin 1995. Mund të shkojë ekipi kombëtar i Kosovës të luajë në vendet arabe dhe jam i bindur që në aeroport atje me mijëra veta do t'i presin. Mund të punohet më shumë për t'u njohur më mirë mes vete, Kosova, po t'i njihnin mirë arabët bukuritë e saj, do të bëhej vendi i tyre i preferuar ku do të kalonin pushimet.

Për fund, uroj që shtetet arabe ta njohin sa më parë shtetin e Kosovës dhe që kjo të bëhet urëlidhëse ndërmjet Lindjes e Perëndimit.

MUHAMED MUFAKU

Universiteti Al Al-Bajt, Jordani

Unë vërtet do të kisha dëshirë të shtroj disa vërejtje që kanë të bëjnë me panelin e parë, apo mund ta lidhin panelin e parë me panelin e dytë, dhe që kanë të bëjnë me temën kryesore të panelit, pra diskursi arab ndaj Kosovës.

Vërejtja e parë ka të bëjë me fjalimin e z. Veton Surroit, dhe besoj që është me rëndësi ta kemi parasysh edhe një herë në këtë panel që këtu gjeneralizohet kur bisedohet për Botën Arabe në përgjithësi sikurse është vërtetë një botë me fjalë tjera e ndërlidhur, se ka një institucion (Liga Arabe), që ka një politikë të jashtme, etj. Kjo nuk është e vërtetë, është si të them një iluzion. Kemi disa shtete që kanë kundërtënie dhe dallime të mëdha, prandaj duhet ta kemi parasysh këtë kur të kalojmë në diskursin arab, sepse diskursi arab ndaj Kosovës nuk është i njëjtë qoftë në përgjithësi apo brenda vet shteteve.

Vërejtja e dytë ka të bëjë poashtu me fjalimin e profesorit Ridwan Said kur bëri një dallim shumë të rëndësishëm për ne, qëndrimi arab duhet të vështrohet në dy rrafsh: në rrafshin e parë, të sistemeve dhe regjimeve, dhe në rrafshin e dytë, të popujve. Vërtetë ai që di së paku diçka për Botën Arabe menjëherë i vëren dhe i dallon këto dy qëndrime. Për shembull në çfarëdo vendi, në Siri, ose në Irak ose në Kuvajt, kemi distancë të madhe midis dy qëndrimeve.

Vërejtja e tretë që u dëgjua në panelin e parë shpeshherë flitet që në Arabi apo në vendet arabe nuk dinë shumë për Kosovën. Kjo nuk është e vërtetë dhe duhet të eliminohet poashtu në këtë panel. Nuk është e vërtetë që në Botën Arabe nuk dinë. Tash në Google apo në çfarëdo uebsajti tjetër mund të dalin qindra e mijëra artikuj për Kosovën, pra nuk është e vërtetë që atje nuk dihet për Kosovën.

OMAR KOUCH

Gazeta al-Arab e Katarit, Liban

Çështja e Kosovës ka zënë një vend të konsiderueshëm në ligjërimin politik arab përgjatë viteve 1999- 2008. Qëndrimet ndaj çështjes kosovare merreshin varësisht nga diskurset, nga orientimet politike dhe nga orientimet ideologjike të subjekteve qëndrimarrëse arabe. Aq të ndryshme ishin qëndrimet sa pati, sidomos për çështjen e pavarësisë së Kosovës, nga qëndrime asnjëse e indiferente deri në qëndrime përkrahëse. Mënyrën si u trajtua shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 në ligjërimin politik arab mund ta parashtrojmë e ta analizojmë më së miri duke folur veç e veç për këto tri nivele: nivelin zyrtar, nivelin popullor dhe nivelin intelektual.

Niveli zyrtar

Ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës qëndrimi zyrtar, pra qëndrimi i qeverive dhe i sistemeve politike arabe u karakterizua nga heshtja. Asnjë shtet arab nuk e njohu pavarësinë e Kosovës. Tërheq vëmendjen fakti që informimi zyrtar arab, sidomos televizionet satelitore arabe u sollën me negativizëm e me mosinteresi ndaj një ngjarjeje të madhe siç është shpallja e pavarësisë së një vendi. Ky mosinteresi i çudit edhe më shumë kur dihet që manifestimet që organizuan populli i Kosovës për të shprehur gëzimin për arritjen e tyre më të madhe e të shumëpritur përbënin material informativ interesant për mjetet e shikuara të informimit. Reagime zyrtare arabe ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës pati shumë pak dhe, për aq sa pati, ishin befasuese. Liga Arabe iu përmbajt heshtjes, sikur të ishte organizatë që s'ka lidhje me çka ngjan në botën e jashtme dhe që nuk ka strategji e qëllime të caktuara.

Egjipti u mjaftua me të shprehur dëshirën që në Ballkan të ketë stabilitet. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Egjiptit Husame Zeki-u shprehu dëshirën e tij që të gjitha lëvizjet ndërkombëtare e rajonale që do ta pasonin shpalljen e pavarësisë t'i udhëhiqte logjika e dialogut dhe e mirëkuptimit.

Përgjegjës në Pushtetin Palestinez u përpoqën ta lidhnin shpalljen e pavarësisë së Kosovës me shpalljen e pavarësisë së vendit të tyre, ndër ta ishte Jasir Addurabbihi-u që deklaroi: " Duhet ta shpallim pavarësinë siç e ka shpallur Kosova". Por këtë marrje modeli e mohoi kreu i Pushtetit Palestinez me këto fjalë: " Ne jemi duke negociuar me izraelitët me qëllimin që të arrijmë marrëveshje paqeje". Kryenegociatori palestinez Saib Urejkati kundërshtoi çdo shpallje të njëanshme të pavarësisë.

Ambasadori i Libisë në Këshillin e Sigurimit deklaroi që Libia nuk pranon që rasti i Kosovës të bëhet precedent për t'u thyer parimi i respektimit të njësive territoriale të shteteve. Xhadulla Aziz Talha-ja shprehu dëshirën e tij që shpallja e pavarësisë së Kosovës të mos e kthente Ballkanin në vitet e trazirave në të nëntëdhjetat e shekullit njëzet, duke shtuar edhe këto fjalë:

"Libia ka qenë dhe do të jetë gjithnjë për përfillje të plotë të parimeve të drejtësisë dhe të konventës ndërkombëtare e cila detyron të respektohen sovraniteti dhe njësia territoriale e të gjitha shteteve".

Aspekte të qëndrimit zyrtar arab

Shumica e shteteve arabe parapëlqyen të heshtnin ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe ende deri më sot nuk kanë ndërtuar ndonjë qëndrim të qartë. Ato po vazhdojnë të vëzhgojnë reagimet ndërkombëtare, sikur po presin që pavarësia të bëhet njëherë realitet e pastaj ta përkrahin.

Në qëndrimin e sotëm të shteteve arabe kanë ndikuar një mal faktorësh, nga të cilët më të rëndësishmit janë këta:

1. Frika se mos njohja e pavarësisë së Kosovës nxit lëvizjet separatiste të pakicat në vendet arabe multietnike, si të kurdët në Irak e Siri dhe të emazikët në Arabinë Perëndimore.

2. Mosdëshira për ta trazuar Rusinë dhe Serbinë, dihet që Rusia ka marrëdhënie të shkëlqyera politike e ekonomike me disa nga vendet arabe.

3. Mungesa e një strategjie politike të shteteve arabe sipas së cilës do të lidheshin interesat nacionale me çështjet ndërkombëtare; mungesa e një koordinimi në veprimin politik arab; përçarja mes vete e shteteve arabe dhe pamundësia për të marrë qëndrim koherent e aktiv.

2. Niveli popullor-islamist

Nuk mund të flitet për qëndrim popullor në vendet arabe, sepse opinioni publik arab mungon në përgjithësi, është joaktiv në rrjedhën e ngjarjeve dhe jo aq i interesuar për çështjet ndërkombëtare. Që populli arab është i preokupuar me sigurimin e jetesës dhe që shumica e tyre janë të ndikuar ose nga qëndrimi zyrtar i shteteve të tyre ose nga qëndrimi i rrymave politike islame; kjo bën që shumica e popullit arab ta shohin çështjen e Kosovës nga këndi fetar. Ata e shohin çështjen e Kosovës siç e shohin rrymat politike islame si çështje të një populli mysliman që duhet ndihmuar dhe të cilit i duhet njohur pavarësia e vendit të vet.

I nisur nga ky këndvështrim, parlamentari islamist në Parlamentin e Kuvajtit, Velid Attabtabai-u, i ka apeluar Qeverisë së Kuvajtit ta njohë pavarësinë e Kosovës duke u shprehur se shumica kosovare janë myslimanë, prandaj meritojnë ndihmesën politike për qëllimin e tyre legjitim për liri e pavarësi. Parlamentari Velid Attabtabai-u i kërkoi Qeverisë së Kuvajtit edhe që t'i thellojë marrëdhëniet kulturore me shtetin e ri të Kosovës.

Në Jordani partia e Ballit Islamik të Punës u ka bërë thirrje gjithë shteteve të botës, në veçanti shteteve arabe e shteteve islamike, që ta njohin pavarësinë e Kosovës. Pokështu qëndron puna me lëvizjet politike islame edhe në vendet e tjera arabe.

3. Niveli intelektual

Qëndrimet e intelektualëve arabë nacionalistë dhe të atyre islamistë karakterizohen nga një ideologji e tepruar. Sipas tyre, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkë me to edhe shtetet perëndimore, gjithnjë mbajnë qëndrim kundër çështjeve të arabëve dhe të myslimanëve, prandaj ndërhyrjen e tyre në luftën e Ballkanit e vlerësojnë se nuk ka qenë për t'i ndihmuar popullit mysliman të Kosovës, porse për qëllime të veta strategjike, nga të cilat qëllime më kryesorë janë dobësimi i Rusisë dhe ndëshkimi i Serbisë duke qenë si trashëgimtare e ish-Jugosllavisë.

Teksa paraqesin analizat dhe teksta marrin qëndrim ndaj pavarësisë së Kosovës, intelektualët arabë nacionalistë dhe ata islamistë, nisen nga premisa se shtetin e

ri të Kosovës e kanë bërë forcat perëndimore jo duke pasur për qëllim thjesht pavarësinë, por interesat e fuqive imperialiste dhe përpjekjen e tyre për ta shtënë në dorë dhe për ta globalizuar Evropën, përpjekje kjo që diktohet kur vërehet shpërbërja e shteteve të njësuara në shtete federale dhe shpërbërja e shteteve federale në shtete nacionale siç është rasti i ish-Jugosllavisë dhe i trashëgimitares së saj Serbisë. Pra, gjithnjë sipas tyre, ne po jetojmë në një botë që po transformohet me të madhe dhe po rindërtohet sërish duke pasur qëllim dominimin.

Një pjesë e këtyre intelektualëve mendojnë që vetë fakti që Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë fuqia më kryesore që qëndron prapa pavarësisë së Kosovës koinspiron idenë që Sh.B.A-të kanë për qëllim të vënë kritere të reja ndërkombëtare e ta bëjnë rastin e Kosovës precedent për vende të tjera. Të nisur nga po kjo ide, disa intelektualë nacionalistë arabë thërrisin që të mos rrëmbenin ndjenjat e të njëjtit pavarësi të Kosovës sepse kjo mund të rrezikojë që të ndahen shtetet arabe, nga jugu i Afrikës deri në perëndim të Azisë, në shtete të vogëltha. Mendonin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë për qëllim që përvojën e Kosovës ta përsëritin në Irak duke ia ndarë Kurdistanin gjë që do të shënonte fillimin e shpërbërjes së shteteve të tjera arabe.

Disa intelektualë islamistë palestinezë shprehnin mendimin se pavarësia e Kosovës ishte rezultat i sakrificës së mijëra dëshmorëve dhe i viteve të shumta, gati një shekull, të qëndresës kosovare ndaj pushtuesit serb dhe këtë mendim e vinin në kontekst të vullnetmarrjes për të vazhduar qëndresën e tyre ndaj pushtuesit izraelit që kanë 60 vjet që e bëjnë.

Kurse, në anën tjetër, intelektualët arabë demokratë dhe ata laicistë shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008 e quajtën si rezultat të konfliktit shumëvjeçar në Ballkan dhe ndoshta, duke marrë parasysh situatën në Ballkan, zgjidhje të vetme apo të paktën një ndër zgjidhjet e mundshme, por që nuk do të jetë e lehtëqëndrueshme duke marrë parasysh problemet e sfidat që shtrihen ajo në Ballkan dhe duke marrë parasysh tensionin që shpejt e shpejt e biejnë aty situatat e ndryshme megjithë përkrahjen e madhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shteteve të Paktit të NATO-s.

NEHAT ISLAMI

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Ju faleminderit, ju përshëndes të gjithëve.

Sot duke i dëgjuar diskutimet e paradites unë shpeshherë e kam parë veten sepse që nga viti 1974 kam jetuar në botën arabe si korrespondent dhe kam qenë korrespondent i të gjitha luftërave, i të gjitha grusht-shteteve, i të gjitha përpjekjeve për demokratizimin e shoqërisë arabe, kështu që munda ti kuptoj dhe përkujtoj ato momente të cilat shtypi i Kosovës, gjegjësit gazeta Rilindja dhe Televizioni i Prishtinës. Dhe tani erdhi koha që edhe shtypi dhe televizionet arabe po na e kthejnë borxhin dhe po shkruajnë rregullisht për Kosovën.

Por çka duhet të bëjmë konkretisht ne kosovarët që të jemi sa më prezent në mediat arabe. Mund të ju them se ne si gazetarë kosovarë kemi bërë më pak seç kanë bërë gazetarët arabë të cilët e kanë vizituar Kosovën, duke filluar nga televizionet e Katarit, Kuvajtit, Egjiptit dhe të tjerëve, si dhe të gazetave kryesore të botes arabe të cilat kanë raportuar rregullisht për ngjarjet kryesore jo vetëm pas luftës së vitit 1999 por edhe para luftës së vitit 1999, për përpjekjet e popullit shqiptar për pavarësi dhe për të shpëtuar nga Millosheviqi të cilin në atëbotë e përkrahte vetëm Libia.

Sot ka ardhur një kohë kur ne duhet vetëm ti përtërijmë raportet tona të cilat i kanë krijuar para 2-3 shekujsh duke filluar nga dinastia e Mehmet Ali Pashës të Egjiptit, i cili si djalë i thjeshtë erdhi nga këto vise dhe krijoi një shtet të pavarur të Egjiptit duke ja njohur të drejtat e popullit egjiptian dhe duke shkollua kuadro nga Egjipti që të bëhen zot të vetvetes. Pastaj duke filluar nga Pashko Vasa i cili për 9-10 vite e udhëhoqi në mënyrë brilante Libanin duke krijuar prej tij një shtet modern, e mos të flas për qindra filozofë e intelektualë të ndryshëm e deri te Filip Shiroka, poeti jonë i njohur, i cili morri pjesë në ndërtimin e hekurudhës dhe portit të Bejrutit.

Me një fjalë ka ardhur koha që edhe ne të njihemi më shumë pikërisht edhe përmes mediave sepse mediat janë dritarja kryesore e cila i njofton më shumë në mes vete njerëzit dhe popujt.

E kam edhe një propozim tjetër: duhet t'i shfrytëzojmë ushtarët e KFOR-it dhe policët ndërkombëtarë të UNMIK-ut nga vendet arabe të cilët kanë shërbyer me nder në Kosovë që nga viti 1999 dhe të cilët kanë kryer detyrat e tyre me nder dhe janë kthyer në vendet e tyre, edhe ata janë dëshmitarët kryesor se cila është e vërteta për Kosovën, çka ka vuajtur Kosova dhe si po zhvillohet Kosova.

E tash do të shkoj pak në poturizëm meqenëse gazetarëve ju falet edhe nëse gabojnë e unë mendoj se çështja e Kosovës e cila u diskutua sot vërtetë në mënyrë të gjithanshme dhe u tha se nuk është çështje arabo-kosovare, por është çështje e çdo shteti arab ndaj Kosovës, do të zgjidhet duke filluar pas 2-3 muajve, dhe pritët të filloj me disa shtete. Por kryesorja në botën arabe çka kam vërejtur unë derisa kam shërbyer si gazetar dhe kam qenë nëpër të gjitha ato shtete, është e rëndësishme që dikush ta thyej akullin, e posaçërisht nëse do të jetë një shtet i cili ka ndikim, atëherë gjërat do të shkojnë shumë më lehtë. Dhe unë mendoj se zgjidhja e çështjes së Golanit, zgjidhja e pavarësisë së Palestinës, dhe Kosova do të jenë simboli i një ndryshimi të madh të raportit që pritët të përmirësohet në mes të shteteve arabe dhe perëndimit.

QEMAJL MORINA

Fakulteti i Studimeve Islame Prishtinë

Më 25 gusht në Prishtinë, me iniciativën e Forumit 2015, do të mbahet konferenca e dytë me titull "Kosova dhe Bota Arabe". Pas konferencës së parë të mbajtur më 14 korrik në Aman të Jordanisë, me iniciativën e Qendrës "al-Quds" për Studime Politike. Në konferencë priten të marrin pjesë një numër i konsideruar i përfaqësuesve të shoqërisë civile nga vende të ndryshme arabe, intelektualë, akademikë dhe analistë, me qëllim që ata të njihen me realitetin e ri të krijuar në Kosovë, pas vitit 1999 e në veçanti pas shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe të pavarur më 17 shkurt 2008.

Kjo iniciativë, është nismë e shoqërisë civile në Kosovë dhe në Botën Arabe, me qëllim të sensibilizimit të opinionit arab për Kosovën, si një çështje në të cilën duhet të kontribuojnë edhe qeveritë arabe në njohjen e pavarësisë së saj, si shtet më i ri në Evropë me shumicë myslimane, por edhe në investimin e kapitalit të vendeve të pasura arabe në sfera të ndryshme të ekonomisë kosovare me interes të përbashkët.

Nga 46 shtete të botës, që kanë njohur deri më tani shtetin e ri të Kosovës, në mesin e tyre nuk është asnjë shtet arab, prej 22 vendeve sa numëron Liga Arabe. Andaj, pyetja që shtrohet para pjesëmarrësve të kësaj konference, qofshin ata arabë apo kosovarë, është ku qëndron shkaku i këtij hezitimi nga qeveritë e vendeve arabe si dhe gjetjen e metodave për tejkalimin e kësaj situatë.

Vendet arabe për shkak marrëdhënieve të tyre strategjike me Federatën Ruse, u ballafaquan me presione të papara, duke kushtëzuar bashkëpunimin e mëtutjeshëm me mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës.

Shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës, nga ana e shqiptarëve në bashkëpunim me Bashkësinë Ndërkombëtare, e ndihmuar nga SHBA-të dhe BE, po paraqitet në ato vende si një lloj secesioni, me të cilin në të ardhmen mund të ballafaqohen edhe vendet arabe.

Diplomacia serbe, duke shfrytëzuar reputacionin që dikur kishte ish-Federata Jugosllave në vendet arabe, si prijëse e Lëvizjes së Vendeve të Painkuadruara dhe qëndrimit parimor të saj rreth çështjes palestineze, kishte bërë efektin e vet në këtë drejtim.

Mungesa e kontakteve institucionale të çfarëdo niveli politik në mes Kosovës dhe vendeve arabe ka bërë që propaganda ruse dhe ajo serbe të ketë sukses në anashkalimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës në këto vende.

Theksimi i përkatësisë sonë perëndimore, në llogari të përkatësisë tonë shpirtërore islame, nga ana e përfaqësuesve tanë politikë, të cilit i përkasin shumica dërrmuese kosovarëve, ka bërë që bota arabe dhe ajo islame pak sa të jetë e irituar nga një veprim i këtillë.

Të gjithë këta faktorë së bashku, duke përfshirë këtu edhe interesat kombëtare të çdo vendi, kanë bërë që në momentin kur ne kemi nevojë për atë pjesë të botës, të hezitojnë të na dalin në ndihmë, ashtu siç ne kemi shpresuar.

Argumentet tona bindëse në favor të njohjes së pavarësisë së Kosovës nga vendet arabe janë:

E para: Besimi i vendeve arabe në të drejtën e popujve në vetëvendosje. Sepse të gjitha ato vende kanë kaluar nëpër një periudhë të tillë, nga e cila drejtë nuk mund të përjashtohet as Kosova dhe populli i saj.

E dyta: Besimi i vendeve arabe në solidaritetin njerëzor dhe atë islam.

E treta: Realitetet e reja të krijuara pas shembjes së murit të Berlinit, qoftë në ish-Bashkimin Sovjetik, nga gjermadhat e të cilit dolën 16 shtete të reja. Dalja e Sllovakisë nga ish-Çekosllovakia. Nga ish-Federata Jugosllave, u formuan 7 shtete, Kosova është episodi i fundit. Si Rusia ashtu edhe Serbia në fillim ishin kundër pavarësisë së shteteve të reja, por me kalimin e kohës ato u pajtuan me realitetin e ri të krijuar në terren. E njëjta do të ndodh me Kosovën, pas një kohe jo fort të gjatë, kur Serbia do ta njohë Kosovën dhe do të vendos marrëdhënie diplomatike me të.

E katërta: Pavarësia e Kosovës nuk mund të quhet akt i njëanshëm, ashtu siç përpiqet ta paraqet këtë propaganda serbe para botës. Për arsye se ky akt i shpalljes së pavarësisë u bë pas një periudhe bisedimesh që zgjatën më shumë se dy vjet në mes palës kosovare dhe asaj serbe nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, pas së cilës përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, presidenti finlandez, Marti Ahtisari doli me propozimin e tij, të cilin pala kosovare e pranoi, kurse pala serbe e refuzoi. Sipas të cilit, Kosova shpallej shtet i pavarur nën mbikëqyrje ndërkombëtare, në ndërkohë që pakica serbe fitonte të drejta dhe privilegje të shumta, në aspektin kombëtar dhe atë të trashëgimisë kulturore e fetare.

E pesta: Serbia aktuale nuk ka asgjë të përbashkët me ish-Federatën Jugosllave të Titos dhe heggjemonizmi serb për formimin e Serbisë së Madhe ishin shkak jo vetëm i shkatërrimit të ish-Federatës Jugosllave, por edhe i të gjitha tragjediave që ndodhën në ish-Jugosllavinë.

E gjashta: Rezultat i agresionit serb i mbështetur në faktorin etnik, por edhe në atë fetar pësuan shumë popuj si kroatët, myslimanët dhe shqiptarët e Kosovës.

E shtata: Se kjo luftë kishte edhe përmasa fetare flasin faktet se gjatë luftërave të fundit në shënjestër të soldateskës serbe ishin spastrimi etnik dhe fetar i myslimanëve si dhe xhamitë e tyre, qofshin në Bosnjë e Hercegovinë apo në Kosovë.

E teta: Mbi 90% të arrestuarve dhe të gjykuarve në Gjyqin e Hagës për krimet në ish-Jugosllavinë, jo vetëm se janë me përkatësi serbe, por edhe përfaqësojnë elitën e pushtetmbajtësve, gjë që tregon se agresioni dhe gjenocidi ishte mirë përgatitur. Këto dite duhet të gjykohet elita që ishte në pushtet për krimet në Kosovë, kurse pak ditë më parë u arrestua kriminelin Radovan Karaxhiq, ish-kryetari Republikës Serbe në Bosnje e Hercegovinë deh arkitekt për masakrën e Srebrenicës

Për këtë, Kosova ka nevojë për një kujdes të veçantë nga qeveritë e vendeve arabe dhe islame për ta njohur realitetin e ri të krijuar në këtë pjesë të botës. Në veçanti kur ajo ka përkrahjen pa rezervë të SHBA-së dhe shumicës dërrmuese të vendeve të Bashkimit Evropian. Krahës njohjes së pavarësisë, vendet arabe dhe islame janë

të thirrura që ato në praktikë ta tregojnë solidaritetin e tyre islam në një përkrahje të fuqishme ekonomike në shenjë solidariteti për qëndresën heroike dhe sakrificat që populli i Kosovës dha për lirinë e tij brenda një periudhe për më shumë se një shekulli.

Shpresojmë se ky mesazh nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina do të arrijë tek mbretërit, princat, sulltanët dhe presidentët e qeverive të vendeve arabe dhe islame dhe se ata do të jenë në nivel të përgjegjësisë së tyre historike t'i përgjigjen apelit të një populli të vogël, por krenar, i cili me gjakun e tij shkruajti historinë më të re.

MOHANNAD MUBAIDIN

Universiteti Filadelfia në Amman, Jordani

Jam vërtet i gëzuar që për të dytën herë gjendem në Kosovë dhe për këtë sinqerisht falënderoj Forumin 2015 që më dha rastin. Për të parën herë isha vjet po në këtë sallë ku ishim mbledhur për të kontribuar për çështjen "Gjashtë shekuj të Islamit në trojet shqiptare" kur dhe pata fatin të takoja intelektualë të shquar.

E kujtoj mirë që kur u kthyem, në shtypin jordanëz dhe në shtypin saudit shkruam për shtetin e premtuar të Kosovës e për endrrën e kosovarëve për shtet.

Në këtë ndërkohë çështja kosovare zuri vend të mirë në gazetatat e revistat arabe, për të në to u shkrua deri në editoriale. Edhe televizionet, sidomos ato satelitore e trajtuan mirë, me sa di unë, televizioni "Alxhezira" ka ardhur në Kosovë për të përgatitur një emision të veçantë për Kosovën.

Mundësi njohjeje me Kosovën, krahas mjeteve të informimit, botës arabe i dha shumë edhe konferenca për Kosovën që u organizua para dy muajsh në Aman.

Kur flitet për negativizmin për të cilin pjesërisht u shqua sjellja e informimit arab ndaj Kosovës, duhet të kemi parasysh se me negativizëm nganjëherë flitet për Kosovën edhe në informimin perëndimor.

Kur u shpall pavarësia më 17 shkurt 2008, qëllova në Itali dhe në një gazetë të atjeshme lexova të vlerësohej pavarësia si bombë për Evropën. Më duket që artikulli në fjalë ishte botuar në ditën e parë pas shpalljes së pavarësisë, e kujtoj me siguri të plotë që ditën që kam lexuar këtë artikull e kam pas marrë në telefon myftiun e Kosovës, mr. Naim Tërnavë për t'ia uruar pavarësinë.

Kur përmend negativizmin me të cilin e trajtojnë çështjen e Kosovës edhe disa medime joarabe, nuk kam për qëllim të zhvlerësoj kritikën për negativizmin me të cilin e trajton çështjen kosovare një pjesë e informimit arab. Kurrsesi, madje mendoj që edhe mënyrën e bashkëpunimit tonë me kosovarët duhet ta drejtojë logjika e bashkëpunimit ndërmjet shteteve dhe jo logjika e bashkëpunimit ndërmjet popujve.

Prandaj, i mbështetur në mendimin e sipërdhënë, sa flasim në plan politik për çështjen kosovare, s'po më duket me vend prirja që të flasim për historinë e përbashkët, për identitetin e përbashkët e për marrëdhëniet kulturore në të kaluarën.

Kosovarët sikur po përqëndrohen të na bindin për të drejtën e tyre për ta pasur shtet në ndërkohë që shtetet arabe, veç njërit, s'kanë problem me njohjen e Kosovës për shtet, të paktën s'kanë publikuar të kenë ndonjë problem, kurse çështja se kur do ta shpallin njohjen është çështje tjetër dhe ne nuk e dimë.

Bashkëpunimi ndërmjet shteteve bëhet sipas disa koncepteve që i dinë specialistët dhe që s'është rendi këtu të shpjegohen, por po përsërit mendimin që dhashë më lart se ne që tani duhet të sillemi ndaj Kosovës si ndaj një shteti.

Do sqaruar mirë edhe çështja e fesë. Njohja eventuale e pavarësisë së Kosovës nga shtetet arabe do të ndërmerret thjesht mbështetur në të drejtën e kosovarëve për vetëvendosje dhe përgjithësisht në aspekt human dhe jo për shkak të identitetit të përbashkët fetar.

Vërtet feja islame ashtu siç është përbërës i identitetit arab dihet që është përbërës edhe i identitetit kosovar, ama s'ka përse të diskutohet kjo në aspektin politik, mund të kishte rëndësi ky diskutim sikur të ndodhej Kosova në fazën e ndërtimit të identitetit, por ajo tashmë e ka tejkaluar këtë fazë.

Krahas që duhet të sillemi ndaj Kosovës si ndaj një shteti, duhet gjithashtu që të mos presim shpalljen e njohjes nga shtetet arabe për të thelluar marrëdhëniet. Qendrat kulturore e shoqëria civile s'duhet të presin asgjë për të ndërmarrë hapa për thellimin e marrëdhënieve arabo-kosovare. Si fushë me rëndësi do të përmendja këtu sportin që është jashtëzakonisht me rëndësi, universitetet e edhe kujdesin për fëmijët kosovarë që lufta i ka lënë pa kujdestarë, ka shumë shoqata arabe që mund të merrnin përsipër kujdesin ndaj tyre.

Duke e përmbyllur fjalimin, të shpreh dëshirën që shtetet arabe të njohin sa më parë për shtet Kosovën dhe që tash e tutje trajtimi ynë politik ndaj çështjeve të njëri-tjetrit vend të jetë trajtim ndërshtetëror e jo ndërpopullor.

HAZEM AMEEN

Gazeta al-Hayat, Liban

I ndikuar nga vërejtja që dha shoku Muflih Udvan, po shtoj kujdesin që e folura ime të jetë sa më brenda çështjes për të cilën jemi mbledhur këtu. Unë merrem me gazetari, kryesisht me gazetari të shkruar, prandaj dhe e shoh të rendit që të flas për praninë e çështjes kosovare në informimin arab. Fillimisht do të përpiqem të përcaktoj fillet e pranisë me të madhe të çështjes kosovare në informimin arab, dhe pastaj do të jap mendimin për shkaqet pse, me gjithë vëllimin e madh të pranisë në informimin arab, çështja kosovare nuk po arrin të jetë aty në qendër të vëmendjes.

Ndodhitë që ngjanë viteve 1999-2000 i dhanë rastin çështjes kosovare të prezentohej në informimin arab. Madje, këto ndodhi, jo vetëm që i dhanë rast prezantimit të ngjeshur çështjes kosovare në informimin arab, por i dhanë rast edhe shoqërisë arabe të njihet për të parën herë me faktin se paska një vend të ish-Jugosllavisë që qenka me shumicë myslimane e që u quejtka Kosovë. Në informimin dhe shoqërinë arabe, të njëjtën mënyrë depërtimi ka njohur edhe Bosnja e Hercegovina, me dalimin, - kuptohet, - kohor.

Kurse fakti i papëlqyer nga të gjithë ne pse çështja kosovare nuk po arrin të jetë në qendër të informimit arab, mendoj se u detyrohet këtyre dy shkaqeve:

1. Informimi arab është tepër i politizuar. rend të parë në informimin arab zënë ngjarjet e nxehta. Duke qenë punët kështu në informimin arab, procesi i ndërtimit "të qetë" të shtetit të Kosovës mund të zërë aty vetëm rend të tretë a të katërt të përparësive. Kjo gjë sigurisht që nuk vlen edhe për informimin botëror në të cilin, ndryshe nga informimi arab, kryeçështje kanë nisur të bëhen pikërisht çështjet e multiethnicitetit, të të drejtave të njeriut e të pajtimit të grupeve që kanë qenë më herët në konflikt.

2. Shkaku i dytë është i natyrës politike. Që Kosova shfaq prirjen e shquar duke iu drejtuar botës perëndimore për ta bindur me respektim të pakicave, me respektim të të drejtave të njeriut, me përmbushje të standardeve ekonomike e ligjore, kjo gjë i bën sistemet arabe dhe një pjesë të madhe të opinionit publik që çështjen e Kosovës ta ndjejnë për të huaj. Kështu, sepse, siç dihet, ka keqkuptim të madh të botës arabe islame ndaj këtyre vlerave.

3. Por nëse flasim për të ardhmen, me të drejtë mund të parashikojmë një rol të madh të përvojës së re kosovare në drejtim të përafrimit ndërmjet botës arabe dhe këtyre vlerave.

Gjasat që Kosova të luajë këtë rol përafrues janë të mëdha, sepse edhe kosovarët kanë një afri kulturore me Lindjen në njërin anë dhe në anën tjetër, edhe arabët, duke i ditur për myslimanë kosovarët, u janë gëzuar arritjeve të tyre.

Po e përmbyll fjalimin duke shprehur shpresën që sa më parë Kosova të ketë hapësirë shumë ende më të madhe në informimin arab dhe të zërë aty kryet e vendit, nga çka sigurisht që do të ndikoheshin pozitivisht sistemet tona dhe opinionit publik.

MUFLEH ODWAN

Sektori i Kulturës në Pallatin Mbretëror, Jordani

Para së gjithash le të falënderoj Forumin 2015 për organizimin e kësaj konference dhe le të shpreh kënaqësinë që m'u dha rasti të marrë pjesë dhe të kem paraqitjen time në këtë konferencë.

Me qëllim që të orientoj drejt dëgjimin e bashëpjesëmarrësve në këtë konferencë duke shmangur ndonjë keqkuptim të mundshëm, - ende pa ia nisur fjalimit që kam përgatitur, - e shoh të udhës që të shpjegohem për cilësinë e prezencës sime. Ndonëse, siç më prezantoi dr. Muhamed Mufaku, ushtroj funksion të lartë në Mbretërinë e Jordanisë, fjalimi im këtu është fjalim i një vështruesi dhe jo i një vendimmarrësi të një shteti, sepse detyra ime prej drejtorit të Seksionit të Kulturës në Mbretërinë e Jordanisë dhe prej anëtarit të disa institucioneve kulturore që merren me kulturë, civilizim, mendim e informim, është e natyrës kulturore, pra që nuk ka të bëjë me vendimmarrjen politike.

Vërejtja që u fol shumë për marrëdhëniet historike e kulturore, për identitetin e përbashkët fetar dhe për gjëra të ngjashme me këto që janë aksioma që s'mund t'i vërë në dyshim askush, poashtu me entuziazëm u shpreh dëshira e shpresa për thellim të marrëdhënieve e për njohje. Mendoj se s'bën ta huqim thelbin e arsyes pse jemi mbledhur këtu, jemi përballë një pyetjeje politike e cila kërkon edhe përgjigje pikërisht nga fusha politike. Pyetja është: a do ta njohin shtetet arabe për shtet Kosovën? Kësaj pyetjeje po mundohem t'i përgjigjem pjesërisht duke u përqëndruar së përgjigjuri vetëm sa i përket Jordanisë, shtetit tim.

Po përpiqem që së pari të vë në dukje disa tregues që i japin përmbajtje fatlume parashikimeve tona për marrëdhëniet ndërmjet Jordanisë dhe Kosovës në të ardhmen dhe së dyti të përmend disa veprimtari në potencë që, po të ndërmerreshin, sipas mendimit tim, do t'u shërbenin shumë pozitivisht marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona. Treguesit për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve tona që do t'i përmend janë të natyrave të ndryshme: tregues zyrtarë e tregues popullorë varësisht se a i referohen pushtetarëve apo popullit; tregues më të drejtpërdrejtë e tregues më të tërthortë po të krahasohen mes vete; tregues teorikë e tregues praktikë varësisht nga fakti se me çfarë veprimtarie kanë të bëjnë.

Nga këta tregues po përpiqem të gjej më të rëndësishmit dhe po i parashtroj sipas një renditjeje të rastësishme:

1. Para disa muajsh mbreti ynë ishte i pranishëm në Parlamentin Evropian në Bruksel, ku mbajti një fjalim në të cilin ndër të tjera ka përmendur admirimin e tij që Evropa respekton të gjitha identitetet dhe ka përmendur me admirim dhe duke e quajtur për aksiomë parimin e respektimit të së drejtës së vetëvendosjes të popujve. Në këtë fjalim të mbretit shoh një shenjë që për mendimin tim paralajmëron mjaft edhe për marrëdhëniet pozitive ndërmjet dy vendeve tona.

2. Shumë kohë para se të shpallej pavarësia e Kosovës, në vitin 2000, mbretëresha jonë pati ardhur në Kosovë dhe ka përkrahur disa projekte me interes për Kosovën dhe ka dhënë një kontribut human, gjë që vështirë të ndodhte sikur të mos ishte interesimi i shtuar i shtetit tonë për të ardhmen e Kosovës.

3. Në Jordani ka disa qendra akademike që kanë lidhje në një mënyrë a në një tjetër me kosovarët. Vetëm në Universitetit "Alulbejt" janë disa kosovarë që kanë mbaruar studimet e prej tyre që tash ponojnë si profesorë dhe të cilët luajnë rol gjithnjë e më të madh për afrues ndërmjet dy vendeve tona.

4. Jordanezët dhe kosovarët i bëjnë bashkë shpesh herë edhe interesimet e përbashkëta për çështje globale. Ka pasur dhe ka kontakte ndërmjet të interesuarve jordanezë e shqiptarë për marrëdhëniet ndërmjet civilizimeve. Te ne nga të interesuarit për këtë fushë ka princër, me disa prej të cilëve, me sa di unë, është takuar ish-muftiu, dekani i Fakultetit të Studimeve Islame doc. Rexhep Boja. Myftiu i Kosovës para disa ditësh është takuar me drejtorin e Qendrës "Alulbejt" Emir Elgazi i cili ka ndikim të fuqishëm vendimmarrës në shtetin tonë.

5. Ka pasur dhe vazhdon të ketë prezencë jordaneze në Kosovë përmes pjesëtarëve, me përkatësi jordaneze, të Forcat Paqeruajtëse. Këta pjesëtarë të Forcave Paqeruajtëse që përtërihen vazhdimisht, kur kthehen në Jordani bëjnë punë ambasadorësh për Kosovën.

6. Konferenca për çështjen e Kosovës që u organizua në Aman para disa muajsh e që është e para e llojit të vet që organizohet në një vend arab pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Sigurisht, kjo konferencë nuk do të lejohej që të mbahej e të shtrohej aty çështja e njohjes së Kosovës për shtet sikur të mos kishte shenja, - të paktën, të tërthorta, - se Jordania do ta njohë për shtet Kosovën.

7. Në mediet e shkruara e elektronike në Jordani gjithnjë e më shumë trajtohet çështja e Kosovës, madje edhe nga analistët më të shquar të vendit pa munguar edhe zëri drejtpërdrejt apeluar për ta njohur sa më parë shtetin e Kosovës.

Kurse, nga veprimtaritë që duhet të ndërmerren e që për mendimin tim do të ndikojnë shumë pozitivisht në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve tona, po shquaj këto tri:

1. Të themelohet një Komision i Përbashkët Popullor i cili vazhdimisht të vërë në dukje mekanizmat me të cilët mund të thelloheshin marrëdhëniet; të përcaktojë fushat në të cilat mund të bashkëpunojmë; të ndikojë që mediet e shkruara dhe ato elektronike arabe sa më shumë të trajtojnë çështjen e Kosovës; t'u bëjë presion parlamenteve arabe në atë mënyrë që, edhe nëse në politikat e një vendi arab të paraqitet një tregues negativ, të arrijnë t'i kundërvihen me sukses duke e pakuptimësuar.

2. Të gjenden e të shfrytëzohen mënyra nxitjeje që vetë popujt arabë në forma të ndryshme të ushtrojnë presion te qeveritarët e vet për ta marrë vendimin me të cilin Kosova të njihet për shtet.

3. Të nxiten investitorët arabë nga Kosova. Fakti që te ju është duke ndodhur procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike ndoshta e lehtëson këtë punë. Të gjithë e dimë që shpeshherë vendimit politik i paraprin dhe e përcakton vendimi ekonomik.

PËR FORUM 2015

Forum 2015 është një projekt i Fondacionit SOROS dhe Institutit RIINVEST, që ofron ekspertizë dhe avokon për çështjet zhvillimore në Kosovë. Forum 2015 përmes aktiviteteve të ndryshme, nxit debate mbi tema aktuale dhe ndihmon zhvillimin e një kulture të avancuar politike. Në perspektivë të gjerë, Forum 2015 synon përgatitjen e Kosovës për integrim në struktura Euro-Atlantike.

Tryezat e deritashme të diskutimeve (seminaret dhe konferencat)

Kosova (C) e Re – Ku është interesi kombëtar në këtë projekt? – 14 Prill 2009
 Imazhi ndërkombëtar i Kosovës – 21 Nëntor 2008
 Privatizim dhe Post-Privatizimi në Kosovë – 9 Tetor 2008
 Kosova dhe Bota Arabe II (konferenca në Prishtinë) – 25 Gusht 2008
 Kosova dhe Bota Arabe I (konferenca në Amman) – 14 Korrik 2008
 Asorbimi i fondeve të para-anëtarësimit në BE – 11 Prill 2008
 Diaspora dhe Politikat e Migracionit – 18 Dhjetor 2007
 Puna e Kuvendit të Kosovës 2004-2007 (dokumentar) – Nëntor, 2007
 Platforma Civile për Zgjedhjet 2007 – 31 Tetor 2007
 Identiteti Evropian i Kosovës – 26 & 27 Qershor 2007
 Politika e Jashtme e Kosovës pas statusit – 9 Maj 2007
 Një Përrallë Moderne – Kosova C 2100 – 18 Prill 2007
 Statusi pas statusit - Prezenca e ardhshme ndërkombëtarë në Kosovë – 14 Dhjetor 2006
 Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – 10 Nëntor 2006
 Dialogu i decentralizimit në Kosovë – 14 Qershor 2006
 Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – 18 Maj 2006
 Kultura fiskale dhe qëndrueshmëria buxhetore – 19 Janar 2006
 60 vjetori i OKB-së – Një zhvillim për të gjithë – 24 Tetor 2005
 Statusi kundër status quos – 1 Qershor 2005
 Mediat në Kosovë: sfidat e gazetarisë së pavarur dhe të qëndrueshme – 21 Mars 2005
 Kosova dhe integrimi i saj në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë – 23 Dhjetor 2004
 Kosova pas pesë vitesh: cila është ardhmëria? – 9-10 Korrik 2004
 Statusi i pronës shoqërore në Kosovë: kontestet dhe privatizimi – 4 Qershor 2004
 Privatizimi në Kosovë: mbarëvajtja dhe pengesat – 9 Mars 2004
 Sistemi zgjedhor në Kosovë: përparësitë dhe të metat – Shkurt 2004
 Operacionalizimi i standardeve – 26 Nëntor 2003
 Platforma e dialogut Prishtinë-Beograd – 7 Tetor 2003
 Samiti i Selanikut – sfidat e integritimit evropian – 11 Qershor 2003

Publikimet e deritashme

Kosova një vit pas (dokumentar) – Shkurt, 2009
 Imazhi çon peshë – Nëntor, 2008
 Privatizimi dhe Post-Privatizimi në Kosovë – Shtator, 2008
 Një Përrallë Moderne (dokumentar) – Prill, 2008
 Absorbimi i fondeve të para-anëtarësimit në BE – Mars, 2008
 Diaspora dhe Politikat e Migracionit – Dhjetor, 2007
 Puna e Kuvendit të Kosovës 2004-2007 (dokumentar) – Nëntor, 2007
 Identiteti Evropian i Kosovës – Nëntor, 2007

Platforma Civile për Zgjedhjet 2007 – Tetor, 2007
Politika e Jashtme e Kosovës – Shtator, 2007
Një Përrallë Moderne – Kosova C 2100 – Prill, 2007
Statusi pas statusit – Prezenca ndërkombëtare në Kosovë – Shkurt, 2007
Decentralizimi në Kosovë – Manual informativ – Janar, 2007
Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – Nëntor, 2006
Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – Shtator, 2006
Kosova pesë vite më vonë – Çfarë agjende për të ardhmen? – 2005
Pse pavarësia? – Shtator, 2005
Privatizimi në Kosovë – Përparimet dhe ngecjet – Mars, 2004

Për më tepër www.forum2015.org